



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.35

9 prill

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i ERE nr.9, datë 11.2.2011	Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror	1231
Vendim i ERE nr.10, datë 18.2.2011	Për mospranimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Chrome” për marrjen e statusit të klientit tarifor	1246
Vendim i ERE nr.12, datë 22.2.2011	Për miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtarisë së ERE-s gjatë vitit 2010”	1247
Vendim i ERE nr.13, datë 22.2.2011	Për miratimin e rregullave për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit	1247
Vendim i ERE nr.19, datë 4.3.2011	Për pranimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të ERE-s nr.10, datë 18.2.2011	1264
Vendim i ERE nr.20, datë 4.3.2011	Për licencimin e shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike	1265
Vendim i ERE nr.21, datë 4.3.2011	Për licencimin e shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	1266

VENDIM
Nr.9, datë 11.2. 2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT, MODIFIKIMIT,
TRANSFERIMIT TË PJESSHËM OSE TË PLOTË, HEQJEN DHE RINOVIMIN E LICENCAVE
NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 11 dhe 14 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2011, pasi shqyrtoi draftin e propozuar nga grupi i punës për “Rregulloren e procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror (rregullorja bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

RREGULLAT DHE PROCEDURAT
PËR LICENCIMIN, NDRYSHIMIN, TRANSFERIMIN E PJESSHËM OSE TË PLOTË, HEQJEN
DHE RINOVIMIN E LICENCAVE NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore është përgatitur në përputhje me nenin 11 pika 9 dhe nenin 14 pika 7 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

Neni 2
Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore përcakton procedurat e licencimit për:

1. Kryerjen e aktiviteteve, sikurse përcaktuar në ligjin nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, duke specifikuar termat dhe kushtet për dhënien, ndryshimin dhe rinovimin e një licence, si dhe autoritetin e ERE-s për përcaktimin e pagesave për t’u kryer për çdo lloj aplikimi për licencë.

2. Heqjen ose përfundimin e një licence në përputhje me nenin 14 pika 6 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenet 16,17,18 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 3 Përkufizime

Përkufizimet e termave të përcaktuar në:

- i) Ligjin “Për sektorin e gazit natyror” nr.9946, datë 30.6.2008, të ndryshuar; dhe
- ii) Ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” nr.907, datë 22.5.2003, të ndryshuar; dhe
- iii) Rregullat e Praktikës dhe Procedurave të ERE, të ndryshuara,

janë të përfshira në këtë dokument për të gjitha qëllimet. Termat dhe frazat e tjera të përdorura në këtë rregullore kur janë përdorur si emra të përveçëm (me germën e parë të madhe) dhe kur nuk gjenden në ligjet dhe rregulloret e sipërpërmendura, ose sikurse mundet të jetë shpjeguar ndryshe në mënyrë të veçantë, do të kenë kuptimin e përcaktuar si më poshtë:

1. “Aplikant” do të thotë çdo person, i cili aplikon për një licencë sipas kësaj rregulloreje.
2. “Aplikim” do të thotë kërkesa për licencim e shoqëruar nga gjithë bashkësia e dokumenteve, sikurse shpjeguar në nenet 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje.
3. Bordi i Komisionerëve” ose “Bordi” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nga ligji nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
4. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë që vepron në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
5. “Garanci e performancës” do të thotë një angazhim nga shoqëria mëmë e aplikantit ose të licencuarit për të siguruar përmbushjen në mënyrë të ndershme dhe të besueshme prej këtij aplikanti ose të licencuari të të gjithë termave dhe kushteve të licencës. Në rastet kur nuk ka shoqëri mëmë, atëherë çdo pronar që zotëron 5% ose më shumë prej aksioneve ose prej kapitalit të vet në këtë aplikim ose licencë do të lëshojë një garanci performance të tillë.
6. “Garanci financiare” do të thotë një angazhim nga një bankë ose persona të tjerë përgjegjës, të pranueshëm për ERE-n, për të mbuluar dhe siguruar përmbushjen në mënyrë të ndershme dhe të besueshme të detyrimeve financiare të aplikantit ose të licencuarit, sikurse mundet të jetë rasti, sipas termave dhe kushteve të licencës.
7. “Gaz natyror” do të thotë të njëjtin kuptim sikurse përkufizuar në ligjin “Për sektorin e gazit natyror” nr.9946, datë 30.6.2008, i ndryshuar që do të thotë gazi metan, përfshirë gazin shoqëruar, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë në kushte atmosferike normale, i cili, në kuptim të ligjit në fjalë, përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.
8. “Licencë” do të thotë një autorizim i dhënë nga ERE në përputhje me pjesën e tretë të ligji nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe nenit 4 të kësaj rregulloreje.
9. “I licencuar” do të thotë personi që mban një licencë të dhënë nga ERE për të operuar në sektorin e gazit natyror.
10. “OST” do të thotë Operator i Sistemit të Transmetimit.
11. “OSSH” do të thotë Operator i Sistemit të Shpërndarjes.
12. “Person” do të thotë çdo person fizik ose juridik.
13. “Përfaqësues zyrtar” do të thotë personi i emëruar në mënyrë të rregullt për të përfaqësuar aplikuesin ose të licencuarin për të gjitha qëllimet sikurse përcaktuar në këtë rregullore.
14. “Sistem” do të thotë çdo rrjet transmetimi, rrjet shpërndarjeje, impiant GNL ose hapësirë depozitimi, në pronësi ose përdorim/operim nga një i licencuar, përfshirë “linepack”, së bashku me instalimet dhe funksionet e tyre që sigurojnë shërbime ndihmëse, si dhe ato që janë të nevojshme për mundësimin e hyrjes në rrjetet e transmetimit, shpërndarjes dhe impiantet e GNL.
15. “Rregullore” do të thotë ky dokument i titulluar “Rregullat dhe procedurat për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”.

16. "Tarifë aplikimi" është pagesa përkatëse, e vendosur nga Bordi i Komisionerëve në përputhje me nenin 10 të ligji nr.9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, që çdo person ose i licencuar duhet kryejë ndaj ERE-s në përputhje me këtë rregullore për trajtimin e kërkesës së paraqitur për licencim, ndryshim, transferim ose rinovim licence.

Neni 4

Aktivitetet e licencuara

1. ERE mund të japë licenca për veprimtaritë e përcaktuara nga ligji nr.9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, sikurse vijojnë:

- a) Transmetim të gazit natyror;
- b) Shpërndarje të gazit natyror;
- c) Furnizim të gazit natyror (shitje me pakicë);
- ç) Tregtim të gazit natyror (shitje me shumicë);
- d) Operim të hapësirave të depozitimit të gazit natyror;
- dh) Operim të impianteve të GNL-së.

2. Ushtrimi i çdo aktiviteti të sipërpërmendur kërkon licencë të veçantë.

3. Licencat do të lëshohen nga ERE në përputhje me këtë rregullore rast pas rasti dhe do të jenë të mbështetura në licencat model përkatëse të miratuara nga ERE.

Neni 5

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së një licence të lëshuar sipas kësaj rregulloreje për transmetim, shpërndarje, depozitim dhe GNL prej ERE në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje do të jetë për një periudhë prej 30 vitesh me të drejtë aplikimi për rinovim. Kohëzgjatja e vlefshmërisë të një licencë për furnizim dhe tregtim do të jetë për një periudhë prej 5 vitesh me të drejtë aplikimi për rinovim.

KREU II

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR LICENCË

Neni 6

E drejta për të aplikuar për licencë

Çdo person, i cili synon të ndërmarrë një aktivitet në sektorin e gazit natyror në Shqipëri për të cilin duhet licencë dhe, i cili, ka plotësuar kërkesat e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri, mundet të paraqesë një aplikim për t'u pajisur me licencë prej ERE-s.

Neni 7

Përfaqësuesi i aplikantit

1. Përfaqësuesi zyrtar do të përfaqësojë aplikantin përpara ERE-s për çdo çështje që ka të bëjë me aplikimin ose licencën që mundet të lëshohet.

2. Përfaqësuesi zyrtar do t'i paraqesë ERE-s prokurën, vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër të nënshkruar ose miratuar nga aplikanti për caktimin e përfaqësuesit zyrtar si të autorizuarin e vet.

3. Përfaqësuesi zyrtar do t'i paraqesë ERE-s një vendim të shoqërisë ose çdo dokument tjetër të miratuar në mënyrë të rregullt nga aplikanti që autorizon këtë përfaqësues të depozitojë sipas rastit kërkesën për licencë, ose ndryshimin, rinovimin apo transferimin e saj.

4. Detyrat e përfaqësuesit zyrtar janë:

a) të paraqesë aplikimin për licencë, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas neneve 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje;

b) të paraqesë të dhëna dhe informacion shtesë të kërkuar nga ERE gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit për licencë;

c) të përfaqësojë aplikantin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin;

d) të përfaqësojë të licencuarin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me çdo licencë të lëshuar në vijim të një aplikimi.

5. Aplikanti ose i licencuari, kushdo qoftë, mundet të ndërrojë përfaqësuesin e tyre zyrtar, duke paraqitur menjëherë një njoftim, me shkrim pranë ERE-s për këtë ndryshim.

Neni 8

Paraqitja e një aplikimi për licencë

1. Aplikimi konsiston në formatin e aplikimit dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje të plotësuar në mënyrë të rregullt nga aplikanti.

2. Aplikuesi do t'i paguajë ERE-s tarifën e aplikimit në fuqi në kohën kur aplikimi paraqitet.

3. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikanti do të jetë origjinal dhe në gjuhën shqipe dhe në se është kopjuar ose përkthyer prej origjinalit atëherë dokumentet e kopjuara ose të përkthyer duhet të jenë të noterizuara.

4. Certifikatat dhe deklaratimet që mbështesin aplikimin duhet të jenë lëshuar jo më herët se tre muaj prej datës së paraqitjes së aplikimit.

5. Aplikanti do të sigurojë që i gjithë dokumentacioni teknik i paraqitur, së bashku me aplikimin e tij është përgatitur dhe nënshkruar nga ekspertë profesionistë dhe me eksperiencë në fushën përkatëse. ERE mundet të kërkojë që këta ekspertë ta vërtetojnë ekspertizën e tyre.

6. Çdo aplikim i shoqëruar nga dokumentacioni përkatës do të paraqitet në dy kopje.

a) një kopje origjinale ose fotokopje e noterizuar, sikurse përcaktuar në pikën 3 të këtij neni; dhe

b) një fotokopje e të gjithë dokumentacionit sikurse përcaktuar në këtë rregullore.

Neni 9

Format dhe dokumentacioni për aplikim:

1. Forma e aplikimit (për t'u plotësuar nga aplikanti)

Një aplikim për një licencë do të përbëhet nga:

a) Tipi i aplikimit

1 Tipi i aplikimit	<input type="checkbox"/> Licencë <input type="checkbox"/> Rinovim <input type="checkbox"/> Transferim <input type="checkbox"/> Ndryshim
2 Tipi i licencës	<input type="checkbox"/> Transmetim i gazit natyror <input type="checkbox"/> Shpërndarje e gazit natyror <input type="checkbox"/> Furnizim i gazit natyror (shitje me pakicë) <input type="checkbox"/> Tregtim të gazit natyror (shitje me shumicë) <input type="checkbox"/> Operim i hapësirave të depozitimit të gazit natyror <input type="checkbox"/> Operim i impianteve të GNL-së

(Shënim: Vendorsni X në kutinë përkatëse)

b) Informacion i përgjithshëm për aplikantin (për t'u plotësuar nga aplikanti).

1	Emri i aplikantit	
	Numri i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit	
2	Zyra qendrore e shoqërisë	Adresa
		Celular
		Tel/Fax
		E-mail
		Emri
		Pozicioni
3	Përfaqësuesi zyrtar	Adresa
		Celular
		Tel/Fax
		E-mail

c) Të dhëna mbi aplikantin (për t'u plotësuar nga aplikanti).

1	<i>Unë, aplikanti deklaroj se:</i> a) Aplikantit nuk i është hequr asnjëherë ndonjë licencë e akorduar për gazin natyror; ose b) Aplikantit nuk i është refuzuar asnjëherë ndonjë aplikim për licencë për gazin natyror. <i>Në Shqipëri ose vende të tjera</i> <i>Nëse përgjigja e ndonjërës prej pyetjeve (1.a) ose (1.b) është JO, atëherë aplikanti duhet të bashkëngjisë një shpjegim të plotë.</i>	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
2	Unë, përfaqësuesi zyrtar, deklaroj në emër të aplikantit se aplikanti është në dijeni të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi në sektorin e gazit natyror dhe paraqes angazhimin e aplikantit për zbatimin korrekt të tyre.	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
3	A është aplikanti i angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër tregtar në Shqipëri ose vend tjetër? <i>Nëse përgjigja e pyetjes 3 është PO, atëherë aplikanti duhet të bashkëngjisë shpjegime shtesë.</i>	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo

d) Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor
i) Akti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit dhe statuti i shoqërisë tregtare.

ii) Struktura organizative dhe funksionimi administrativ i shoqërisë. Lista e personelit (në përputhje me aktivitetin për të cilin është kërkuar licenca).

iii) Me përjashtim të rasteve të furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç), marrëveshja dhe leja e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

iv) Identiteti i të gjithë personave që kanë interes pronësor tek aplikanti më të madh dhe të barabartë me 5%.

v) Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar.

vi) Lejet dhe autorizimet mjedisore.

e) Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale

i) Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për pagesat e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit.

ii) Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tre viteve të fundit që paraprijnë paraqitjen e aplikimit.

iii) Garancinë e përshtatshme financiare [e paaplikueshme për rastin e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç)] dhe garancinë e performancës që sigurojnë aftësinë e aplikantit për të përmbushur të gjithë detyrimet e tij nën licencën e kërkuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar: largimin përfundimtar të plotë ose të pjesshëm të pajisjeve dhe/ose infrastrukturës dhe rehabilitimin e mjedisit, si dhe mbështetjen menaxheriale, operationale dhe financiare prej pronarëve të aplikantit.

iv) Me përjashtim të rastit të furnizimit (neni 4.1.c) dhe rastit të tregtimit (neni 4.1.ç), një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkatëruara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD. Kjo politikë ose këto politika sigurie do të jenë dhe qëndrojnë në fuqi dhe me efekt të plotë për të gjithë kohëzgjatjen e licencës së kërkuar. Për më tepër i licencuari do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim që do të mund të ndodhë prej, ose të lidhet me, ose të rezultojë prej aktiviteteve të kryera gjatë kohëzgjatjes së licencës.

v) Vërtetimin e kryerjes së pagesës ndaj ERE-s të tarifës së aplikimit në fuqi në momentin e paraqitjes së aplikimit.

vi) Një plan biznesi, i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve, përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve.

vii) Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, ai duhet të këshillohet me ERE-n për këtë synim dhe të japë një garanci të performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi.

2. Dokumente specifike për llojin e licencës në vartësi të tipit të licencës, aplikanti do të paraqesë në ERE dokumentet që vijojnë:

a) Licenca për transmetimin e gazit natyror:

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i) Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve, përfshirë hartën topografike.

ii) Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (*in take*) në sistem dhe të daljes (*off take*) prej sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjete të tjera të transmetimit dhe shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimin dhe terminalin e GNL-së.

iii) Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.

iv) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.

v) Presionet e punës të projektuara, mbështetur në vlerësimet e aplikantit.

vi) Kategoritë dhe lista e konsumatorëve, si dhe livrimet e parashikuara.

- vii) Vendndodhjet e matësve dhe specififikimet.
- viii) Vendndodhjet e kontrollit të cilësisë së gazit.
- ix) Dëshmi të kontratave/angazhimeve për transportin e gazit.
- x) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
- xi) Lidhjet ndërkufitare dhe parametrat e operimit në vendet fqinje.
- xii) Marrëveshjet operacionale të balancimit.
- xiii) Burimi i synuar dhe procedura e prokurimit të gazit natyror të nevojshëm për balancimin e sistemit të transmetimit.
- xiv) Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt.
- xv) Punët e aplikantit për: a) zgjidhjen teknike të propozuar; b) vlerësimin e ndikimit mjedisor; c) vlerësimin e kostos; d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit, të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e transmetimit të gazit natyror të përgatitura nga një shoqëri e specializuar inxhinierike .
- xvi) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.
- xvii) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të sistemit të transmetimit për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- xviii) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit.
 - b) Licenca për shpërndarjen e gazit natyror
 Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit, që përfshijnë sa vijon:
 - i) Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve, përfshirë hartën topografike.
 - ii) Zonën gjeografike të mbuluar nga aplikimi.
 - iii) Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (*in take*) në sistem dhe të daljes (*off take*) prej sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjetet e tjera të transmetimit dhe të shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimin dhe terminalin e GNL-së.
 - iv) Volumet e projektuara ditore për t’u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.
 - v) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.
 - vi) Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e aplikantit.
 - vii) Kategoritë e konsumatoreve dhe livrimet e projektuara.
 - viii) Vendndodhjet e matësve dhe specififikimet.
 - ix) Planet e aromatizimit përfshirë vendndodhjet.
 - x) Dëshmi të kontratave/angazhimeve.
 - xi) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrjen e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
 - xii) Lidhjet ndërrajonale dhe parametrat e operimit të OSSH-së fqinje nëse është e përshtatshme.
 - xiii) Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt, nëse është e përshtatshme.
 - xiv) Punët e aplikantit për: a) zgjidhjen teknike të propozuar; b) vlerësimin e ndikimit mjedisor; c) vlerësimin e kostos; d) parashikimet ekonomike, duke përfshirë mënyrat e financimit, të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e shpërndarjes të gazit natyror të përgatitura nga një firmë e specializuar inxhinierike.
 - xv) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.
 - xvi) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të sistemit të shpërndarjes për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - xvii) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes.

xviii) Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t'u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

c) Licenca për operimin e impianteve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL)

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit, që përfshijnë sa vijon:

i) Tipi i impiantit të rigazifikimit.

ii) Hartat dhe vizatimet që tregojnë vendndodhjen e instalimeve në tokë dhe në det dhe pikën(at) e lidhjes me tubacionet tokësore të transmetimit, përfshirë hapësirat e magazinimit që lidhen me operacionet e GNL-së.

iii) Kapacitetin maksimal teknik, të kontraktuar dhe të disponueshëm në pikën e marrjes (*off take*) prej/për në terminal.

iv) Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.

v) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe matjes dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.

vi) Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e aplikantit.

vii) Programet e synuara të furnizimit dhe madhësia e anijeve cisternë të GNL-së.

viii) Madhësia e rezervuarëve të depozitimit.

ix) Burimet e furnizimit.

x) Kategoritë dhe lista e konsumatoreve të pritshëm, si dhe livrimet e projektuara.

xi) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

xii) Punët e aplikantit për: a) zgjidhjen teknike të propozuar; b) vlerësimin e ndikimit mjedisor; c) vlerësimin e kostos; d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit, të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e GNL-së të përgatitura nga një shoqëri e specializuar inxhinierike.

xiii) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.

xiv) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të impiantit të GNL-së për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

xv) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes të impiantit të GNL-së.

d) Licenca për operimin e hapësirave të magazinimit të gazit natyror

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit, që përfshijnë sa vijon:

i) Vendndodhjen gjeografike të hapësirës së magazinimit nëntokësor dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë një hartë topografike.

ii) Përshkrim të kushteve gjeologjike të hapësirës magazinuese nëntokësore.

iii) Volumi maksimal i magazinueshëm dhe gazi i vet¹ i nevojshëm.

iv) Kërkesat minimale të cilësisë që duhet të plotësojë gazi që do të magazinohet.

v) Profili i debiteve të rilivrimit të gazit natyror.

vi) Presioni maksimal i rezervuarit nëntokësor.

vii) Numri i puseve dhe debitet maksimale të tyre të injektimit dhe të prodhimit.

viii) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe matjes dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.

ix) Kërkesat minimale të cilësisë së gazit që do të livrohet serish dhe instalimet që sigurojnë që cilësia e përcaktuar është arritur.

x) Dëshmi të kontratave/angazhimeve për magazinim.

xi) Kategoritë dhe listën e konsumatorëve.

¹ Termi "i vet" është përdorur në ekuivalencë të termit "cushion gas", i cili nënkupton një volum minimal gazi, i cili qëndron në hapësirat magazinuese për shkak të natyrës së procesit dhe nuk mundet dot të jetë pjesë e volumeve që shkëmbehen.

xii) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

xiii) Punët e aplikantit për: a) zgjidhjen teknike të propozuar; b) vlerësimin e ndikimit mjedisor; c) vlerësimin e kostos; d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit, të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e magazinimit nëntokësor të gazit natyror të përgatitura nga një shoqëri e specializuar inxhinierike.

xiv) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.

xv) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të hapësirave të magazinimit për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

xvi) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së hapësirave të magazinimit.

e) Licenca për tregtim të gazit natyror (shitje me shumicë):

Informacion të përgjithshëm që përfshin sa vijon:

i) Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milionë Nm³, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti.

ii) Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit.

iii) Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.

f) Licencë për furnizim me gaz natyror (shitje me pakicë):

Informacion i përgjithshëm që përfshin sa vijon:

i) Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milionë Nm³, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti.

ii) Garancinë që cilësia e furnizimit me gaz përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit.

iii) Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.

Neni 10

Vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit për licencë

1. Çdo kërkesë për licencë do të dorëzohet në mënyrë zyrtare në zyrën e protokollit të ERE-s. Më tej, kërkesa do të trajtohet në përputhje me këtë rregullore dhe rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s. Brenda 12 ditëve prej depozitimit të kërkesës në zyrën e protokollit, Bordi i ERE-s do të vendosë nëse kërkesa plotëson kushtet minimale për t'u konsideruar si aplikim apo duhet refuzuar. Nëse Bordi i ERE-s refuzon kërkesën për arsyen se kërkesat e neneve 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje nuk janë plotësuar, atëherë ERE do të njoftojë aplikantin me shkrim me anë të një vendimi të argumentuar brenda tri ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi. Nëse Bordi vendos të pranojë aplikimin atëherë procedura e vlerësimit të aplikimit do të vlerësohet që ka filluar në datën kur ky vendim u mor dhe vlerësimi i mëtejshëm do të kryhet në përputhje me këtë Rregullore dhe me Rregullat e Praktikës dhe Procedurave të ERE-s.

2. ERE do të shtyjë marrjen e vendimit të saj deri sa të gjithë kërkesat e aplikimit të jenë plotësuar, por jo më shumë se 90 ditë prej datës së parë të publikimit të kryer në përputhje me pikën 6 të këtij neni, të kërkesës për licencë të dorëzuar në mënyrë zyrtare në zyrën e protokollit të ERE-s.

3. Në rastet kur kërkohet një vendim i Këshillit të Ministrave ose ministrisë përgjegjëse për energjinë sipas ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, atëherë ERE nuk do të hapë procedurë për dhënie licence sipas kësaj rregulloreje deri sa një vendim i tillë miratues të jetë marrë nga Këshilli i Ministrave ose ministria përkatëse.

4. Aplikanti mundet të paraqesë një kërkesë të re për licencë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe duke marrë në konsideratë komentet e bëra nga ERE në refuzimin e kërkesës së mëparshme sikurse shpjeguar në pikën 1 këtij neni.

5. Jo më vonë se tri ditë pune pas marrjes së vendimit prej ERE për të filluar vlerësimin e aplikimit, një njoftim për vendimin në fjalë do të publikohet përgjatë dy ditëve pune në vijim, në jo më pak se tri gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin. Në të gjitha rastet publikimi i aplikimit do të jetë në përputhje me nenin 16 të ligjit nr.9072, të datës 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

6. Njoftimi i përshkruar në pikën 5 të këtij neni do të përmbajë:

a) Një përmbledhje të shkurtër të aplikimit;

b) Një njoftim se çdo kundërshtim, ankesë ose informacion tjetër prej palëve të interesuara dhe prej publikut të gjerë mundet të paraqiten në ERE brenda afatit kohor të përcaktuar në vijim në pikën 7 të këtij neni.

7. Për një periudhë prej dy muajsh prej ditës së parë të publikimit të njoftimit prej ERE-s, aplikimi së bashku me gjithë dokumentacionin dhe informacionin shoqërues do të jenë të disponueshëm për publikun gjatë orarit normal zyrtar të zyrtarëve të ERE-s. Brenda kësaj periudhe, të gjitha palët e interesuara dhe anëtarë të publikut të gjerë mund të paraqesin me shkrim kundërshtime, ankesa ose informacione të tjera që kanë të bëjnë me aplikimin.

8. Në momentin e paraqitjes së aplikimit, aplikanti mundet të deklarojë që disa prej informacioneve që përfshihen në aplikim janë me natyrë të ndjeshme tregtare dhe aplikanti mundet të kërkojë që këto informacione të mbahen konfidenciale dhe të mos i jepen palëve të interesuara ose publikut të gjerë. Një vendim i ERE-s për fillimin e procedurave për vlerësimin e aplikimit do të përmbajë edhe një vendim në lidhje me kërkesën e aplikantit për ruajtjen e konfidencialitetit.

9. Sikurse ta gjejë të arsyeshme, ERE mund t'i kërkojë aplikantit të japë informacione të tjera ose plotësuese, të cilat kanë lidhje me vlerësimin dhe miratimin e aplikimit. Në rast se aplikanti nuk pranon të japë informacione të tilla ERE mundet ta refuzojë aplikimin.

10. Në fund të periudhës në dispozicion për komente nga publiku sikurse përshkruar në pikën 7 të këtij neni drejtoritë përkatëse të ERE-s do të vlerësojnë dhe analizojnë;

a) Aplikimin dhe të gjithë informacionin e paraqitur nga aplikanti në fillim ose sikurse mundet t'i jetë kërkuar nga ERE;

b) Kundërshtimet, komentet dhe çdo informacion tjetër të paraqitur prej palëve të interesuara dhe

c) Kundërshtimet, komentet dhe çdo informacion tjetër të paraqitur nga pjesëtarë të publikut të gjerë.

11. Mbështetur në këtë vlerësim dhe analizë, drejtoritë përkatëse të ERE-s do të përgatitin dhe paraqesin Bordit të ERE-s një relacion me shkrim që do të përmbajë rekomandimet për një vendim për të miratuar apo refuzuar dhënien e licencës sikurse parashikuar në pikën 2 të nenit 11. Këto rekomandime do të jenë të argumentuara dhe në përputhje me këtë rregullore, rregullat dhe procedurat e përgjithshme të ERE-s dhe ligjet përkatëse në fuqi.

Neni 11

Vendimmarrja e Bordit të ERE-s

1. Me plotësimin e afatit të paraqitjes së kundërshtimeve dhe ankesave, Bordi i ERE-s do të vlerësojë aplikimin mbështetur në kriteret e parashikuara prej ligjit nr.9946 i datës 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe kriteret e parashikuara në nenet 16, 17, 18 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Në marrjen e vendimit për të miratuar apo refuzuar një aplikim për licencë sikurse për termat dhe kushtet e kësaj licence, Bordi i ERE-s do të marrë në konsideratë dhe mbështesë vendimin e vet në kriteret që vijojnë;

a) Aplikimin dhe plotësinë e saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në përputhje me këtë rregullore dhe me kërkesat për informacion shtesë nëse ka pasur të tilla nga ana e ERE-s;

b) Relacionin e drejtorive përkatëse të ERE-s të përgatitur në përputhje me pikën 11 të nenit 10.

c) Kundërshtimet dhe ankesat që kanë lidhje me çështjen, nëse ka të tilla, të paraqitura nga palët e interesuara ose prej publikut të gjerë në lidhje me aplikimin në proces vlerësimi.

d) Në rastin e aplikimeve për licenca për transmetim dhe shpërndarje, ekzistencën e licencave ende të vlefshme të lëshuara më parë për të njëjtat aktivitete në vendndodhjen dhe territorin në të cilin aktiviteti i propozuar synon të kryhet.

e) Funksonimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të pajisjeve, impianteve dhe/ose rrjeteve (nuk zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj rregulloreje).

f) Kërkesën për burime të gazit natyror.

g) Kërkesat për sigurinë kombëtare, jetën e banoreve, pronat, shëndetin dhe rendin publik. (nuk zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj rregulloreje).

h) Angazhimet financiare të ndërmarra dhe garancitë e ofruara prej aplikantit.

i) Mbrojtjen e mjedisit (nuk zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj rregulloreje).

j) Promovimin e përdorimit eficient të energjisë në sektorin e gazit natyror.

k) Detyrimet e shërbimit publik të pritshme prej aplikantit sikurse përcaktuar nga legjislacioni shqiptar e në veçanti nga neni 45 i ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

l) Promovimin e një tregu konkurrues të gazit natyror dhe, të paktën në rastin e furnizimit të konsumatoreve tariforë, principin e kostos më të ulët për furnizim me gaz natyror.

m) Sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me gaz natyror dhe aftësinë për rrjedhje në kah të kundërt të këtij furnizimi brenda Republikës së Shqipërisë.

3. Në përputhje me nenin 15 të rregullave të saj të praktikës dhe procedurave, ERE do të njoftojë me shkrim të gjithë palët e interesuara për vendimin e Bordit brenda 3 ditësh prej marrjes së këtij vendimi.

Neni 12

Dhënia ose refuzimi i licencës

1. Bordi i ERE-s do ta marrë vendimin përfundimtar për dhënien ose refuzimin e licencës brenda 90 ditëve nga dita e parë e publikimit të njoftimit në media, duke e mbështetur vendimin e tij në bazë të kriterëve të parashtruara në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

2. Vendimi përfundimtar i Bordit do të jetë me shkrim dhe do të përmbajë arsyet për dhënien ose refuzimin e licencës.

3. Vendimi i ERE për miratimin ose refuzimin e dhënies së një licence sipas kësaj rregulloreje do të publikohet në Fletoren Zyrtare.

4. Vendimi i ERE-s mundet të apelohe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

5. Në rastet kur ERE nuk pranon të rinovojë ose zgjasë vlefshmërinë një licence zbatohen kushtet e nenit 16 të kësaj rregulloreje.

KREU III

NDRYSHIMI, RINOVIMI DHE TRANSFERIMI I LICENCAVE

Neni 13

Procedurat e ndryshimit të licencave

1. ERE mundet që me kërkesën e të licencuarit ose me iniciativën e vet të ndryshojë termat dhe kushtet e një licence që ajo konsideron të përshtatshme, në përputhje me procedurat e

përcaktuara nga ligji nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar dhe neni 19 i ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. ERE mundet të vendosë të ndryshojë një licencë në rastet që vijojnë:

a) kur ka ndryshime të disa rrethanave (siç mundet të jenë kuadri ligjor, vendime të gjykatës) që kanë ndodhur ndërmjet datës së lëshimit të licencës dhe datës së kërkesës për ndryshim; ose

b) kur ka ngjarje që sjellin efekte të konsiderueshme në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes ose në tregun e gazit natyror; ose

c) kur ka ndryshime ligjore, teknike ose financiare që e bëjnë të pamundur plotësimin e pjesëshëm ose të plotë të termave dhe kushteve të parashikuara në licencë;

3. Nëse ERE vendos të ndryshojë licencën, ajo do t'i lëshojë të licencuarit një licencë të amenduar me ndryshimet e bëra, duke anuluar në këtë mënyrë pjesët e licencës që nuk janë më të vlefshme. Nëse i licencuari kundërshton termat dhe kushtet e licencës së ndryshuar atëherë do të zbatohen kushtet e nenit 16 të kësaj rregulloreje.

4. Në rastin e një kërkesë nga i licencuari për një ndryshim të licencës së vet, ERE do të zbatojë të njëjtat afate dhe procedura si në rastin e licencimit sikurse përcaktohet nga kjo rregullore. Kjo kërkesë për ndryshim do të përfshijë:

a) Tekstin e propozuar të ndryshimit specifik që është kërkuar.

b) Informacion me shkrim që shpjegon arsyet e kërkesës për ndryshim të licencës.

c) Vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër që vërteton kërkesën e të licencuarit për ndryshimin specifik të licencës.

5. Kërkesa nga një i licencuar për ndryshimin e licencës do të ndjekë të njëjtat procedura sikurse përshkruar në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Rinovimi i licencës

1. Jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i vlefshmërisë së licencës, i licencuari mundet t'i kërkojë ERE-s rinovim të licencës duke paraqitur dokumentet dhe informacionet që vijojnë:

a) Formën e aplikimit sikurse përcaktuar në pikat 1(a) dhe 1(b) të nenit 9;

b) Informacionin ligjor, administrativ dhe pronësor sikurse përcaktuar në pikën 1(d) të nenit 9;

c) Dokumentet dhe garancitë financiare dhe fiskale sikurse përcaktuar në pikën 1(e) të nenit 9;

d) Çdo propozim për ndryshim ose zëvendësim në dokumentacionin teknik.

2. ERE mundet t'i kërkojë të licencuarit të paraqesë informacion tjetër ose shtesë të cilin ERE e konsideron të nevojshëm për të marrë një vendim për aplikimin e të licencuarit për rinovimin e licencës.

3. Kriteret për vendimmarrjen e Bordit do të jenë të njëjta, sikurse për rastin e licencimit.

4. Bordi mundet të marrë në konsideratë plotësimin e termave dhe kushteve të licencës për aktivitetin e licencuar prej aplikantit në të kaluarën.

5. ERE do të publikojë një njoftim për aplikimin për rinovim të licencës në përputhje me të njëjtat procedura, sikurse përcaktuar në pikën 5 të nenit 10 të kësaj rregulloreje.

6. Bordi do të marrë vendim për rinovimin ose jo të licencës jo më vonë se 90 ditë kalendarike pas paraqitjes së kërkesës në përputhje me këtë rregullore.

Neni 15

Transferimi i pjesëshëm ose i plotë i licencës ose asetëve të të licencuarit

1. Me kërkesën e të licencuarit, ERE mundet të transferojë licencën pjesërisht ose plotësisht te një person tjetër në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Në rast të transferimit të plotë ose të pjesshëm të pronësisë së aseteve, personi tek i cili do të transferohen asetet, do të aplikojë tek ERE për një licencë të re për aktivitetet që do të transferohen duke paraqitur dokumentacionin që vijon:

- a) Formën e aplikimit sikurse përcaktuar në pikat 1(a), 1(b) dhe 1(c) të nenit 9;
- b) Dokumentacionin ligjor, administrativ dhe pronësor, sikurse përcaktuar në pikën 1(d) të nenit 9;
- c) Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale, sikurse përcaktuar në pikën 1(e) të nenit 9;
- d) Çdo propozim për ndryshim ose zëvendësim në dokumentacionin teknik;
- e) Një deklaratë me faktet e plota që kanë të bëjnë me nevojën ose arsyet për transferimin e propozuar;
- f) Transferimi do të bëhet sipas kushteve të “Rregullores së procedurave për kalimin e aseteve të të licencuarve”.

3. Me marrjen e vendimit prej ERE-s për fillimin e procedurave për vlerësimin e aplikimit për transferimin e plotë ose të pjesshëm të licencës, ERE do të publikojë aplikimin në përputhje me pikën 5 të nenit 10 të kësaj rregulloreje. Kushtet e pikës 6 të nenit 10 do të zbatohen për të gjitha aplikimet për transferim licence.

4. ERE do të marrë një vendim për miratimin ose refuzimin e aplikimit për transferimin e plotë ose të pjesshëm të licencës brenda 90 ditëve kalendarike prej ditës së fillimit të procedurave për vlerësimin e aplikimit dhe gjatë kësaj periudhe mbajtësi aktual i licencës do të vazhdojë të kryejë shërbimet në përputhje me detyrimet e licencës në fuqi.

5. I propozuari për aplikant për licencë duhet të:

- a) ketë aftësitë dhe eksperiencën teknike dhe financiare për të marrë përsipër detyrimet që i takojnë të licencuarit nën këtë licencë;
- b) pranojë dhe marrë përsipër të gjithë termat dhe kushtet e licencës përfshirë dhënien e një garancie financiare dhe të një garancie të performancës; dhe
- c) jetë i regjistruar dhe në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore për të bërë biznes në Shqipëri.

6. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, çdo transferim i tillë do të jetë i kushtëzuar nga miratimi paraprak me shkrim i ERE-s, i cili nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

7. Njoftimi për një transferim të synuar, përshkruar në pikën 2 të këtij neni do të shoqërohet të paktën nga sa vijon:

- a) Një kopje e dokumentit ligjor të propozuar ose evidencë tjetër dokumentare e transferimit të synuar;
- b) Dokumente që kanë lidhje me aplikantin për licencë të propozuar, të cilat do të përfshijnë:
 - i) Bilancet financiare të audituara dhe të dhëna të tjera për të siguruar bindjen e arsyeshme të ERE-s për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje;
 - ii) Të dhëna për identitetin e pronarëve të aplikantit për licencë të propozuar, duke pasur parasysh që për rastin e një shoqërie, aksionet e së cilës janë regjistruar në një bursë të mirënjohur, këto të dhëna do të kërkohen për pronarët kryesorë (sikurse përcaktuar ose përdorur prej ligjeve ose rregullave në fuqi në bazë të të cilave këto shoqëri kanë regjistruar aksionet e tyre).
 - iii) Të dhëna për shoqëritë mëma direkte dhe indirekte, përfshirë identitetin e pronarëve të shoqërisë mëmë finale të aplikantit për licencë të propozuar,
 - iv) Çdo dokument ose informacion tjetër shtesë që ERE në mënyrë të arsyeshme mund ta gjykojë të nevojshëm për të marrë një vendim për miratimin e transferimit të propozuar.

8. Brenda 90 ditëve kalendarike pas marrjes prej ERE-s të të gjithë dokumentacionit të kërkuar dhe të dhënave të tjera, ERE do të nxjerrë vendimin e vet për miratimin ose refuzimin e transferimit të propozuar. Publikimi dhe marrja e komenteve të publikut do të bëhet sipas dispozitave të nenit 10.

KREU IV
SANKSIONET DHE HEQJA E LICENCËS

Neni 16
Sanksionet kundër të licencuarit

1. ERE në përputhje me nenin 51 të ligji nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, mund të aplikojë sanksione ndaj një të licencuari ose të heqë një licencë të gazit natyror për secilën prej arsyeve në vijim:

- a) Shkelje e legjislacionit në fuqi;
- b) Mosplotësimi nga ana e të licencuarit në një masë të konsiderueshme i ndonjërit prej termave dhe kushteve të licencës;
- c) Rrezikimi ose dëmtimi i mjedisit;
- d) Rrezikimi i jetës ose sigurisë së personave ose dëmtimi apo shkatërrimi i pronës;
- e) Mospagimi nga ana e të licencuarit i detyrimeve financiare ndaj ERE-s brenda afateve kohore të përcaktuara;
- f) Mosfillimi i aktivitetit të licencuar brenda afatit të miratuar, ose paaftësia e të licencuarit pasi ka filluar, të vazhdojë kryerjen e aktivitetit të licencuar sipas afateve dhe në mënyrë të përshtatshme e në përputhje me termat dhe kushtet e licencës;
- g) Falimentim, paaftësi për të kryer pagesa ose shpërbërja e të licencuarit;
- h) Mosplotësimi i detyrimeve për mbrojtjen e konsumatorit, sikurse përcaktuar nga legjislacioni në fuqi ose nga rregullat e ERE-s;
- i) Kryerja e një transaksioni që është në kundërshtim me interesat e shtetit shqiptar,
- j) Moszbatimi i vendimeve të ERE-s për tarifat.

2. Pas dëgjimit të argumenteve dhe fakteve të qenësishme të palëve të interesuara dhe duke demonstruar një gjykim të mbështetur, ERE mundet të vendosë një ose më shumë prej sanksioneve të mëposhtme kundër një të licencuari:

- a) Urdhëron të licencuarin të ndërmarrë masa korrigjuese ose veprime të tjera në një mënyrë të përcaktuar dhe/ose brenda një afati të përcaktuar kohor.
- b) Vendos gjobë kundër të licencuarit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- c) Ndryshon termat dhe kushtet e licencës.
- d) Heq Licencën.
- e) Cakton një administrator të përkohshëm që të operojë sistemet përkatëse në pritje të dhënies së një licence një të licencuari të ri në përputhje me pikën 10 të këtij neni.
- f) Pushim të çështjes për mungesë arsyesh të mjaftueshme për vendosje sanksionesh.

3. Të gjitha propozimet për vendosjen e sanksioneve kundër një të licencuari do të fillohen nga ERE ose me iniciativën e saj, ose duke u nisur nga kërkesa e bërë prej një pale të interesuar. Në rastin e një kërkesë për sanksione prej një pale të interesuar përpara se të fillohet ndonjë veprim sipas këtij neni, ERE do të verifikojë bazën e ekzistencës së kësaj kërkesë në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

4. Një i licencuar mundet të kërkojë që ERE të heqë licencën e tij në çdo kohë. ERE do të miratojë kërkesën e të licencuarit për heqjen e licencës me kushtin që i licencuari të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e tij monetare dhe çdo detyrim tjetër. Në një rast të tillë ERE ose do të emërojë një administrator ose do të urdhërojë të licencuarin të operojë përkohësisht sistemin përkatës në pritje të dhënies së një licence të re. Në rastin e emërimit të një administratori, Bordi do t'i japë këtij administratori një licencë të përkohshme që përcakton termat dhe kushtet sipas të cilave ky administrator duhet të operojë sistemin në fjalë në pritje të lëshimit të një licence të re.

5. Procedura për vendosjen e sanksioneve një të licencuari do të zhvillohet në përputhje me Rregullat e Praktikës dhe Procedurave të ERE-s dhe me ligjin “Për sektorin e gazit natyror, nr.9946, datë 30.6.2008”, të ndryshuar.

6. ERE do të njoftojë të licencuarin për fillimin e procedurës për vendosjen e sanksioneve sipas kësaj rregulloreje. Një njoftim i tillë do të:

- a) Jetë me shkrim dhe do t'i dorëzohet përfaqësuesit zyrtar të të licencuarit;
- b) Japë arsyet ose mbështetje të tjera për ankesën;
- c) Identifikojë drejtorinë brenda ERE-s, që është përgjegjëse për trajtimin e çështjes;
- d) Japë propozimin e ERE-s për zgjidhjen e çështjes;
- e) Japë propozimet për qëndrimin përfundimtar të ERE-s².

7. Brenda 30 ditëve kalendarike prej marrjes së njoftimit, sikurse përshkruar në pikën 6 të këtij neni, dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s, i licencuari ka të drejtën të;

a. Përgjigjet me shkrim për çështjet e përmendura në njoftim. Kjo përgjigje do të protokollohet në ERE.

b. Kërkojë një seancë dëgjimore me ERE-n për çështjen përpara marrjes së ndonjë vendimi nga Bordi i Komisionerëve.

8. Në rastet kur Bordi heq një licencë dhe emëron një administrator të operojë përkohësisht sistemin në fjalë, në të njëjtën kohë me nxjerrjen e vendimit të vet, Bordi do t'i lëshojë këtij administratori një licencë të përkohshme që përcakton termat dhe kushtet nën të cilat ky administrator duhet të operojë Sistemin në fjalë në pritje të lëshimit të licencës së re.

9. Çdo vendim i ERE-s për heqjen e një licence mundet të ankimohet në Gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare. Kur ERE vendos të dënojë një të licencuar me gjobë, në përputhje me nenin 51 të ligjit "Për sektorin e gazit natyror" nr.9946, datë 30.6.2008, të ndryshuar, shqyrtimi, ankimi dhe ekzekutimi i vendimit bëhet sipas Kodit të Procedurës Administrative dhe të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", të ndryshuar.

10. Në rastet kur një licencë hiqet sipas këtij neni, titujt e pronësisë mbi asetet e të licencuarit do të transferohen përkundrejt një kompensimi të arsyeshëm në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe dispozitat e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen e në përdorim të përkohshëm të pronës private për interesa publike", të ndryshuar.

KREU V LËSHIMI DHE REGJISTRIMI I LICENCAVE

Neni 17

Regjistri i licencave

1. Pas marrjes së vendimit nga ERE për licencimin, transferimin e pjesshëm/të plotë rinovimin ose ndryshimin e licencës, licenca përkatëse i lëshohet aplikantit.

2. Një kopje e çdo licencë të lëshuar për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e gazit natyror mbahet nga ERE dhe regjistrohet në regjistrin e licencave.

3. Regjistri i licencave do të mbahet me shkrim nga Sekretaria e Bordit të Komisionerëve sikurse edhe në formë elektronike. Ai do të publikohet, gjithashtu, në faqen e internetit të ERE-s dhe do të rifreskohet rregullisht.

4. Në regjistër mbahen informacionet që vijojnë:

- a) Numri i regjistrimit të licencës dhe kategoria;
- b) Data e miratimit të licencës;
- c) Data e lëshimit të licencës;
- d) Emri i të licencuarit;
- e) Nënshkrimi i përfaqësuesit zyrtarë si provë e marrjes e licencës prej të licencuarit;
- f) Zona e shërbimit;
- g) Adresa e zyrës qendrore të të licencuarit;
- h) Përshkrimi i aktivitetit i cili është objekt i licencës së lëshuar;
- i) Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës.

² Kjo ka të bëjë me qëndrimet përkatëse që ERE do të jetë e detyruar të marrë nëse nuk janë ndërmarrë masat korrektive të propozuara ose jo.

Neni 18
Informimi i publikut

1. Regjistri i licencave është i disponueshëm për publikun gjatë orarit zyrtar të punës.
2. Mbështetur në kërkesën e argumentuar të aplikantit, ERE mund të vendosë që pjesë të informacionit përbërës të aplikimit, dokumenteve të tij mbështetëse apo shoqëruese, ose në vetë licencën janë me natyrë të ndjeshme komerciale dhe nuk duhet të ekspozohen. I gjithë informacioni i klasifikuar si i tillë do të trajtohet si konfidencial dhe do të jetë i mbrojtur prej ekspozimit dhe do të trajtohet vetëm sipas një vendimi të ERE-s, i marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Informacioni konfidencial nuk do të bëhet i disponueshëm për publikun për aq sa publikimi i tyre mundet të sjellë dëme ekonomike.

**KREU VI
DISPOZITA TË FUNDME**

Neni 19
Amendimi i rregullores

Kjo rregullore mund të amendohet me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM
Nr.10, datë 18.2.2011**

**PËR MOSPRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ALBANIAN CHROME” PËR
MARRJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TARIFOR**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 7 dhe 8 të “Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, pikës 7, germa “a” të modelit shqiptar të tregut, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2009 dhe pikës IV.2 të rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike miratuar me vendimin nr.68, datë 23.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.2.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Chrome”, për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e klientit tarifor,

konstatoi se:

- Së pari, aplikimi për kthimin e “Albanian Chrome” në statusin e klientit tarifor nga data 1 shkurt 2011, nuk i plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar, si dhe rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është paraqitur në respektim të afateve të përcaktuara nga këto rregullore.

- Së dyti, kalimi i “Albanian Chrome” nga klient i kualifikuar në klient tarifor sipas vendimit nr.100, datë 7.12.2010, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nuk është i mundshëm, pasi kthimi i tij në klient tarifor do të sillte kosto të reja shtesë për KESH sh.a., si dhe do të cenonte sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët tariforë, nëse këto kosto nuk do t’i mbulohen nga KESH sh.a. nëpërmjet tarifës së furnizimit me shumicë të energjisë elektrike për këtë konsumator.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë kërkesën e shoqërisë “Albanian Chrome” për marrjen e statusit të klientit tarifor sipas kërkesës së tij për kthimin në klient tarifor nga data 1 shkurt 2011, dhe sipas çmimeve të miratuara nga ERE me vendimin nr.100, datë 7.12.2010.

2. “Albanian Chrome” mund të aplikojë për marrjen e statusit të klientit tarifor në përputhje me kriteret, siç përcaktohen në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe rregullat e tregut, me një çmim shtesë siç mund të përcaktohet nga ERE.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “Albanian Chrome” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.12, datë 22.2.2011

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S “GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGISË DHE VEPRIMTARISË SË ERE-S GJATË VITIT 2010”

Në zbatim të neneve 9 dhe 10 pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, neni 13, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 22.2.2010, pasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2010”, të paraqitur nga Kryetari i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2010”, që do t’i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (raporti bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.13, datë 22.2. 2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikës 7, germa b, të modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X, të rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.6.2008, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.2.2011, pasi shqyrtoi draftin e propozuar nga grupi i punës për miratim e rregullave për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit. (Rregullorja bashkëlidhur këtij vendimi.)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

Draft, shkurt, 2011

RREGULLAT PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONEVE

1. Hyrje dhe dispozita të përgjithshme

Këto rregulla hartohen në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 dhe Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr.68, datë 23.6.2008.

Këto rregulla specifikojnë procedurat dhe kriteret e ankandit për alokimin e kapaciteteve disponibël ndërkufitar ndërmjet zonës së kontrollit të OST sh.a. dhe operatorëve të sistemit të transmetimit fqinjë në linjat e interkonjeksionit në të dyja drejtimet, përfshirë linjat Shqipëri-Greqi, Shqipëri-Kosovë dhe Shqipëri-Mali i Zi.

Këto rregulla përcaktojnë kërkesat që pjesëmarrësit e tregut duhet të përmbushin për të marrë pjesë në ankandet vjetore, mujore, ditore, procedurat e zhvillimit të ankandit, dhënien e të drejtës së transmetimit fizik, kushtet për akses në tregun sekondar të së drejtës së transmetimit fizik dhe shfrytëzimin e të drejtës së transmetimit fizik.

Kapacitetet e transmetimit disponibël (ATC) për eksport nga Shqipëria dhe për import në Shqipëri nëpërmjet linjave të interkonjeksionit me Greqinë, Kosovën dhe Malin e Zi alokohen në mënyrë eksplicite në ankandin vjetor, mujor dhe ditor të mbajtur për secilin drejtim.

Këto rregulla kanë për qëllim që të sigurojnë një proces transparent dhe të monitoruar nga ana e Entit Rregullator të Energjisë për alokimin e kapaciteteve disponibël të interkonjeksionit.

OST-ja, si operator i sistemit të transmetimit në Republikën e Shqipërisë, është i ngarkuar të përcaktojë vlerat e kapacitetit transmetues ndërkufitar dhe rakordimin e tyre me TSO-të fqinje në përputhje me kriteret e përcaktuar nga ENTSO-E (Rrjeti European i Operatorëve të Transmetimit të Energjisë Elektrike).

OST-ja përgatit dhe dërgon për miratim në ERE rregullat e alokimit të ATC-së në zonën e vet të kontrollit për vitin kalendarik pasardhës, të cilat do të jenë të vlefshme për të gjithë vitin kalendarik pasardhës. Versioni korent i rregullave duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së jo më vonë se data 15 nëntor për vitin kalendarik pasardhës. Pas publikimit të rregullave, pjesëmarrësit e tregut janë të detyruar të ndjekin në mënyrë korrekte rregullat e publikuara në faqen e internetit të OST-së.

Për një periudhë tranzitore, e cila do të zgjasë deri më 31.12.2011, një pjesë e kapacitetit disponibël hyrës (importit) të interkonjeksionit do të rezervohet si më poshtë:

a) 50% e kapacitetit disponibël i rezervohet OSSH-së (CEZ shpërndarje) për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes;

b) 25% e kapacitetit disponibël i rezervohet furnizuesit publik me shumicë (KESH sh.a.) për mbulimin e nevojave për energji të klientëve tariforë.

c) Nga 25% i mbetur, OST-ja do t'i rezervojë kapacitetet e nevojshme furnizuesve të kualifikuar që kanë një kontratë efektive me klientët e kualifikuar. Në rastet kur ky kapacitet nuk i plotëson kërkesat e tyre, ai do të ndahet në mënyrë propocionale.

d) Pjesa e mbetur e kapacitetit disponibël të interkoneksionit hyrës pasi të jenë rezervuar kapacitetet sipas pikave “a”, “b” dhe “c” të mësipërme, do të ofrohen në ankand nga ana e OST sh.a.

e) Asnjë e drejtë e siguruar si më sipër nuk do t'i transferohet palëve të treta në rast se kapacitetet e siguruar nuk përdoren për një nga qëllimet e parashikuara në pikat “a”, “b” dhe “c” të mësipërme.

2. Shkurtime dhe përcaktime

TTC (Total Transfer Capacity) – kapaciteti total transmetues është programi i shkëmbimit maksimal ndërmjet zonave të kontrollit të shoqëruara me standardet e sigurisë së operimit në të dy sistemet, mbi bazën e informacionit disponibël të operimit të prishëm të rrjetit, përfshirë gjenerimin dhe ngarkesën.

TRM (Transmission Reliability Margin) – rezerva e sigurisë së sistemit të transmetit është një pjesë e kapacitetit transmetues ndërkufitar, e nevojshme për punën e sigurt të sistemit transmetues, duke konsideruar pasaktësinë e llogaritjes së kapaciteteve transmetuese dhe skedulimeve që mbështeten mbi to. Kjo pasaktësi rrjedh si rezultat i operimit të rregullimit sekondar, nevojës për shkëmbime emergjente dhe devijimeve në kohë reale, nga skedulimi. TSO-të fqinje rakordojnë bashkarisht vlerën e TRM-së.

NTC (Net Transfer Capacity) – kapaciteti neto i transmetimit është programi maksimal i shkëmbimit ndërmjet dy TSO-ve fqinjë duke konsideruar standardet e sigurisë të zbatueshme në të gjitha zonat e kontrollit të zonës sinkrone, si dhe duke konsideruar, gjithashtu, pasigurinë teknike që lidhet me parashikimin e kushteve të punës së rrjetit, dhe llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$NTC = TTC - TRM$$

AAC (Already Allocated Capacity) – kapaciteti transmetues i alokuar është i gjithë kapaciteti transmetues, që tashmë i është alokuar pjesëmarrësve të tregut në bazë të këtyre rregullave, pas plotësimit të detyrimeve financiare kundrejt OST-së nga ana e pjesëmarrësve të tregut.

ATC (Available Transmission Capacity) – kapaciteti transmetues disponibël është diferenca ndërmjet kapacitetit neto dhe kapacitetit tashmë të alokuar, dhe llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$ATC = NTC - AAC$$

Pjesëmarrës i tregut është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik, dhe që ka nënshkruar me OST-në kontratën për përdorimin e kapacitetit ndërkufitar.

Pjesëmarrës i ankandit është pjesëmarrësi i tregut që paraqet në ankand kërkesën për alokimin e të drejtës së transmetimit të kapacitetit ndërkufitar, me kushtin që më parë të ketë nënshkruar me OST-në kontratën përkatëse të përdorimit të kapacitetit ndërkufitar.

Periudha e ankandit është periudha në të cilën aplikohet alokimi i kapacitetit. Kjo periudhë mund të jetë një vit, një muaj ose periudha njëditore.

Oferta e ankandit janë vlerat e çiftit kapacitet – çmim (MW - €/MWh) në kërkesën e paraqitur nga pjesëmarrësi në ankand.

Alokimi është procesi me të cilin OST-ja i atribuon kapacitetet e transmetimit të pjesëmarrësit e tregut.

Ankandi vjetor është ankandi për alokimin e të drejtës së transmetimit fizik për vitin pasardhës.

Kapaciteti transmetues disponibël (ATC) vjetor është pjesa e kapacitetit transmetues disponibël që alokohet në ankandin vjetor në formën e të drejtës së transmetimit fizik.

Ankandi mujor është ankandi për alokimin e të drejtës së transmetimit fizik për muajin pasardhës.

Kapaciteti transmetues disponibël (ATC) mujor është pjesa e kapaciteteve të transmetimit disponibël që alokohet në ankandin mujor për muajin pasardhës.

Ankandi ditor është ankandi për alokimin e të drejtës së transmetimit fizik për ditën pasardhëse.

Kapaciteti transmetues disponibël ditor është pjesa e kapacitetit transmetues disponibël që alokohet në ankandin ditor.

Kushtet specifike të ankandit do të thotë informacioni i nevojshëm që iu vihet në dispozicion pjesëmarrësve të ankandit nga OST sh.a. në faqen e internetit për një ankand të caktuar.

Mjetet e ankandit do të thotë sistemi i teknologjisë së informacionit (IT) i përdorur nga OST për të marrë ofertat nga pjesëmarrësit e ankandit, përfshirë kryerja e veprimeve dhe shpallja e rezultatit të ankandit.

Faqja e internetit të ankandeve është faqja e internetit të OST-së (operatori i tregut) me përmbajtjen e përcaktuar në nenin 9 të këtyre rregullave.

Dita e ankandit është dita në të cilën do të zhvillohet ankandi, për të cilin ofertat mund të paraqiten deri në afatin e përcaktuar nga OST-ja.

Kongjestion është mbingarkesa e identifikuar në elementet e rrjetit, ose mosplotësimi i kriterit të sigurisë N-1 në shpërndarjen e fluksit dhe/ose analizën e tensionit në procedurën e përgatitjes së regjimit të punës për ditën në avancë ose në kohë reale.

Çmimi marxhinal është çmimi më i ulët i ofertës së fundit të pranuar nga OST-ja në një proces ankandi.

Zotëruesi i kapacitetit është pjesëmarrësi i ankandit që fiton të drejtën e transmetimit ndërkufitar në ankand ose që e fiton këtë të drejtë nëpërmjet transferimit në përputhje me kërkesat e këtyre rregullave.

Tregu sekondar i të drejtës së transmetimit fizik është mekanizmi që lejon transferimin e të drejtës së transmetimit fizik të blerë në ankandin vjetor dhe/ose mujor nga mbajtësi që e ka fituar në ankand të një pjesëmarrës tjetër i tregut sipas këtyre rregullave.

Transferimi i kapacitetit është transferimi i të drejtës së përdorimit të kapacitetit ndërkufitar nga fituesi i ankandit tek një pjesëmarrës tjetër i tregut.

Shkëmbimi ndërkufitar i energjisë është shkëmbimi i energjisë elektrike që pjesëmarrësi i tregut kryen me zonat e kontrollit (TSO) fqinje.

Partneri ndërkufitar është një person nga zona e kontrollit fqinje me të cilin pjesëmarrësi i tregut në Shqipëri ka një kontratë shkëmbimi ndërkufitar.

Zonë kontrolli është pjesa e përcaktuar e rrjetit interkonektiv europian (ENTSO-E), që kontrollohet nga një ose disa TSO.

ERE është Enti Rregullator i Energjisë, me adresë Rr: “Gjergj Fishta”, nr.10, Tiranë, Shqipëri.

ENTSO-E (“European Network of Transmission System Operators for Electricity”) është shoqata e TSO-ve europiane të energjisë elektrike.

3. Dokumentet dhe formularët

Dokumentet dhe formularët bashkëngjitur si anekse janë pjesë përbërëse e këtyre rregullave dhe OST-së i publikon ato në faqen e saj të internetit:

- Formulari i aplikimit për pjesëmarrje në ankandin e kapaciteteve të interkonjeksionit - shtojca 1;
- Modeli i kontratës për të drejtën e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar në kufijtë e zonës së kontrollit të OST-së – shtojca 2;
- Formulari i kërkesës për transferimin e kapacitetit – shtojca 3;
- Formulari i deklaratimit të marrjes të së drejtës së transmetimit ndërkufitar të alokuar nga TSO-të fqinje – shtojca 4;
- Lista e personave të kontaktit në OST - shtojca 5;
- Lista e pjesëmarrësve të tregut që mund të marrin pjesë në ankand dhe në nominimin e skedulimeve – shtojca 6;
- Tabela me vlerat e TTC, TRM, NTC, AAC dhe ATC – shtojca 7;
- Plani vjetor paraprak i remonteve të interkonektorëve – shtojca 8;
- Tabela me rezultatet e ankandit – shtojca 9.

4. Përcaktimi i kapacitetit transmetues dsiponibël (ATC).

OST-ja publikon, 30 ditë përpara datës së zhvillimit të ankandeve vjetore për vitin pasardhës, një skemë të përgjithshme për përllogaritjen e kapacitetit total të transmetimit dhe të kapacitetit të sigurisë së linjës bazuar në realitetet energjetike dhe fizike të rrjetit, e cila do të jetë e vlefshme për vitin pasardhës. Kjo skemë do të jetë objekt i miratimit nga ERE.

Kapaciteti transmetues disponibël (ATC) në kufijtë e zonës së kontrollit të OST-së përcaktohet bashkërisht me TSO-të fqinje në përputhje me rekomandimet e ENTSO-E dhe Kodin e Rrjetit Transmetues.

Vlerat e ATC-së përcaktohen veçmas për çdo kufi dhe drejtim fluksi, dhe ato nuk mund të mblidhen, pra të eliminohen nëpërmjet nxjerrjes së vlerës neto të transmetimit.

OST-ja, për sa është e mundur teknikisht, duhet të nxjerrë një vlerë rezultante (netoje) të kërkesave të kapacitetit të çdo fluksi të energjisë në drejtimin e kundërt mbi linjën e interkonjeksionit të kongjestuar në mënyrë që të përdoret kjo linjë në maksimumin e kapacitetit. Duke marrë plotësisht në konsideratë sigurinë e sistemit, transaksionet që shmangin kongjestionin nuk duhet refuzuar asnjëherë.

Vlera vjetore e ATC-së për çdo interkonektor dhe drejtim fluksi, llogaritet duke konsideruar vlerën minimale mujore që është përdorur apo shfrytëzuar, në tri vitet e fundit, dhe rakordohet me TSO-të fqinje.

Vlera mujore e ATC-së llogaritet në përputhje me rekomandimet e ENTSO-E që konsiston në përgatitjen dhe shkëmbimin e të dhënave të sistemit ndërmjet TSO-ve fqinje dhe formimin e modelit rajonal të transmetimit, mbi të cilin bëhet kontrolli i simulimit të zhvendosjes së energjisë nga një zonë në tjetrën. Llogaritjet bëhen nga çdo TSO, duke kontrolluar nivelin e sigurisë së punës për zonën e vet në rast se hapet (del nga puna) një linjë e caktuar interkonektive ose e rrjetit të brendshëm të transmetimit. Kontrolli përfshin rrjetin e nivelit të tensionit 220 kV dhe 400 kV. Amplituda më e madhe e kapacitetit për të cilën nuk cenohet siguria e punës (niveli i tensionit dhe limiti i rrymës), pranohet si kapaciteti total i mundshëm në atë pikë kufitare.

Kapaciteti neto del duke zbritur nga kapaciteti total marzhin (rezervën) e sigurisë që merr në konsideratë gabimet e mundshme në llogaritje, pasi të dhënat i referohen situatës së rrjetit që parashikohet të jetë në muajin e ardhshëm, si dhe lënies së një kapaciteti rezervë që mund të përdoret në raste emergjence të rënies së pjesshme ose të plotë të ndonjë zone në interkoneksion. Me qenë se llogaritjet bëhen nga çdo TSO, është e mundur që të përftohen dy vlera të ndryshme të NTC-së. Në këto raste, merret si vlerë e NTC-së minimumi i të dy vlerave. Pra, në rastet e mosmarrëveshjes ndërmjet TSO-ve fqinje, zbatohet principi i pranimit të minimumit të dy vlerave të NTC-së në të njëjtin kufi dhe drejtim. Sipas rregullit të përgjithshëm, kapaciteti NTC alokohet në mënyrë të barabartë 50% me 50% në të dyja drejtimet e rrjedhjes së fluksit, nga të dy TSO-të që zotërojnë linjën interkonektive.

Në rast të ndryshimeve sinjifikative të situatës së sistemit në krahasim me situatën e parashikuar, kur janë llogaritur kapacitetet ndërkufitare, OST-ja dhe TSO-ja fqinjë, pas rikalkulimit të kapacitetit ndërkufitar, përcaktojnë në mënyrë bilaterale vlerat e reja të NTC-së e respektivisht ato të ATC-së.

5. Përshkrimi i procedurës së alokimit

5.1. Metoda e alokimit të së drejtës së përdorimit të ATC-së

OST-ja organizon ankande vjetore, mujore dhe ditore për alokimin e të drejtës së përdorimit të kapacitetit disponibël (ATC) në të dyja drejtimet e linjave të interkonjeksionit si më poshtë.

a) Ankandet vjetore në lidhje me të drejtat e transmetimit fizik (PTR) për kapacitetet e transmetimit disponibël (ATC) vjetore nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2011.

Pas hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, OST sh.a. organizon ankand për kapacitetet dalëse të interkonjeksionit (eksportin) për të gjithë periudhën e mbetur të vitit 2011, sipas përcaktimeve të pikës 5.1 për ankandin vjetor.

b) Ankandet mujore në lidhje me të drejtat e transmetimit fizik (PTR) për kapacitetet e transmetimit disponibël (ATC) mujore nga dita e parë deri në ditën e fundit kalendarike të muajit për vitin 2011;

c) Ankandet ditore në lidhje me të drejtat e transmetimit fizik (PTR) për kapacitetet e transmetimit disponibël (ATC) ditore.

Për pjesën e tij të kapacitetit transmetues, OST-ja aplikon metodën e tregut të bazuar në ankandin eksplisit me mënyrë pagese sipas çmimit marxhinal.

Ankandet vjetore

Vlera vjetore e ATC për çdo kufi e drejtim publikohet jo më vonë se data 25 nëntor e vitit V-1, për vitin V, dhe ankandi vjetor organizohet jo më vonë se data 30 nëntor. Ofertat e ankandit vjetor do të dorëzohen nga ofertuesit në zarfe të mbyllura. Datat e sakta dhe informacioni përkatës lidhur me ankandin vjetor do të publikohen në faqen e internetit të OST-së.

OST-ja hap të gjitha ofertat e paraqitura brenda afatit të përcaktuar në prani të çdo përfaqësuesi të autorizuar të pjesëmarrësve në ankand dhe lexon për çdo ofertë:

- Emrin e ofertuesit;
- Kapacitetin e kërkuar në MW;
- Sasinë e kërkuar në MWh;
- Çmimin njësi të çdo oferte euro/MWh;
- Kufirin për të cilin është kërkuar kapaciteti;
- Drejtimin për të cilin është kërkuar kapaciteti.

E drejta e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar të alokuar në ankandet vjetore do të aplikohet nga ora 00:00 e datës 1 janar deri në orën 24:00 të datës 31 dhjetor.

Gjatë periudhave të remonteve të linjave të interkonjeksionit, OST-ja mund të reduktojë të drejtën e përdorimit të kapacitetit të alokuar në ankandet vjetore, në mënyrë proporcionale me reduktimin e vlerës së ATC-së në këto periudha.

Ankandet mujore

Vlerat mujore të ATC për muajin M publikohen jo më vonë se data 15 e muajit M-1, dhe ankandet mujore për muajin M organizohen njëkohësisht për të gjithë kufijtë, jo më vonë se data 20 e muajit M-1. Datat e sakta dhe informacioni përkatës, lidhur me ankandin mujor, do të publikohen në faqen e internetit të OST-së.

Ofertat e ankandit mujor do të dorëzohen nga ofertuesit në zarfe të mbyllura.

Për ankandet mujore, nëse për ndonjë kufi e drejtim, ka disa periudha kohore me vlera të ndryshme të ATC-së, atëherë për çdo periudhë organizohet një ankand i veçantë për vlerën përkatëse të ATC-së.

OST-ja hap të gjitha ofertat e paraqitura brenda afatit të përcaktuar në prani të çdo përfaqësuesi të autorizuar të pjesëmarrësve në ankand dhe lexon për çdo ofertë:

- Emrin e ofertuesit;
- Kapacitetin e kërkuar në MW;
- Sasinë e kërkuar në MWh;
- Çmimin njësi të çdo oferte euro/MWh;
- Kufirin për të cilin është kërkuar kapaciteti;
- Drejtimin për të cilin është kërkuar kapaciteti.

E drejta e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar të alokuar në ankandet mujore do të aplikohet nga ora 00:00 e ditës së parë të muajit M, deri në orën 24:00 të ditës së fundit të periudhës përkatëse që do të publikohet në tabelën e vlerave të ATC-së për muajin në fjalë.

Ankandet ditore

Ankandet ditore mund të mbahen në shtatë (7) ditë të javës në ditën e zhvillimit të ankandit. Për ankandet ditore ndiqen hapat e mëposhtëm:

a) Kapacitetet e transmetimit disponibël (ATC) ditore publikohen në faqen e internetit të ankandeve të OST-së jo më vonë se dita D-2, ora 11:00 pas marrëveshjes reciproke të OST-së me TSO-të e vendeve që i korrespondon linja e interkonjeksionit.

b) Ankandi ditor mbahet ndërmjet orës 13:50 dhe 14:30 të ditës D-2 së ankandit. Procesi i saktë për paraqitjen e ofertave për ankandin ditor përshkruhet në detaje në udhëzimet e ankandit që janë të disponueshme në faqen e internetit të ankandeve në OST. Ankandi ditor përfshin fazat e mëposhtme:

- i) Hapja e procedurës për paraqitjen e ofertës së mbyllur ora 13:15 - 13:45;
- ii) Periudha e heshtur ora 13:45 - 13:50;
- iii) Hapja e procedurës për paraqitjen e kodit të ofertës ora 13:50 - 14:30.

c) Vetëm ato oferta të dorëzuara nga pjesëmarrësit e tregut që përmbushin kërkesat e rregullave të ankandit, veçanërisht ato të kufizimeve të ofertës dhe të dorëzimit të ofertës për ankandin ditor do të pranohen në ankand.

d) Çdo pjesëmarrës tregu njoftohet për rezultatet e ofertës së tij ndërmjet orës 08:05 dhe 8:30 të datës pasardhëse D-1 të datës së zhvillimit të ankandit ditor. Rezultatet e ankandit publikohen në faqen e internetit të OST-së.

e) Programet orare të mësipërme mund të modifikohen nga organizuesi i ankandit (OST) nëpërmjet specifikimeve të ankandit.

f) Të drejtat e transmetimit fizik të alokuara nga OST-ja në ankandet ditore do të jenë objekt i parimit "Përdore ose humbe" (Use It Or Lose It).

OST-ja do të marrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin sa më shpejt të platformës elektronike për zhvillimin e ankandeve.

5.2. Paraqitja e kërkesës për alokim, kapaciteti në ankandet vjetore/mujore/ditore

Paraqitja e kërkesës për alokimin e të drejtës së përdorimit të kapacitetit ndërkufitar do të bëhet me zarfe të mbyllura, për ankandet vjetore dhe mujore dhe e-mail për ankandet ditore, në adresën që jepet nga OST-ja sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullorë.

Kapaciteti i alokuar nga OST-ja nënkupton të drejtën e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar në bandë për çdo orë të periudhës të ankandit përkatës për të gjithë periudhën që mbulon ankandi.

Me paraqitjen e kërkesës për kapacitet transmetimi ndërkuftar, nëse sasia totale e kapacitetit të kërkuar në kufirin dhe drejtimin përkatës është më e madhe se sasia e kapacitetit disponibël (ATC) të publikuar në faqen e internetit të OST-së (ka kongjestion), pjesëmarrësi në ankand merr përsipër detyrimin e bërjes së pagesës për rezervimin e kapacitetit ndërkuftar.

5.3. Mekanizmi i zhvillimit të ankandeve

Kapacitetet e transmetimit disponibël (ATC) alokohen me procedurë ankandi nga OST-ja në formën e të drejtës së transmetimit fizik, në çdo linjë interkonjeksioni dhe drejtim sipas termave dhe dispozitave të këtyre rregullave.

Në një procedurë ankandi, OST-ja klasifikon të gjitha ofertat e vlefshme si vijon:

Rasti 1

Nëse shumica e të gjitha ofertave të dorëzuara për një ankand të caktuar është e barabartë ose më pak se kapacitetet e transmetimit disponibël (ATC), për mbajtësin e të drejtës së transmetimit fizik nuk ka çmim përfundimtar, dhe në këtë rast pjesëmarrësit fitues e fitojnë të drejtën e transmetimit pa kryer asnjë pagesë kundrejt OST-së.

Rasti 2

Nëse shumica e të gjitha ofertave të dorëzuara për një ankand të caktuar e kalon sasinë e kapaciteteve të transmetimit disponibël (ATC), për mbajtësin e të drejtës së transmetimit fizik caktohet çmimi për çdo MWh të alokuar. Për këtë qëllim, ofertat renditen në bazë të çmimit të ofruar, duke filluar me çmimin më të lartë dhe përfunduar me çmimin më të ulët.

Kapacitetet e kërkuara me ofertat jepen sa oferta, e cila përfaqëson nivelin e mësipërm që është shumica e kapaciteteve të interkonjeksionit të kërkuar nga pjesëmarrësit e tregut në kalim të kapaciteteve të transmetimit disponibël (ATC) (oferta marxhinale). Çmimi i ofertës marxhinale është dhe çmimi përfundimtar.

Çmimi përfundimtar i përcaktuar sipas parimeve të mësipërme përdoret si bazë për përlllogaritjen e çmimit të kapaciteteve dhe aplikohet te të gjithë mbajtësit e të drejtës së transmetimit fizik.

Pjesëmarrësit në ankand mund të paraqesin deri në 10 oferta për çdo kufi/drejtim fluksi dhe periudhë kohore të përcaktuar në njoftimin e ankandit. Oferta që paraqitet në ankand përfaqëson një çift vlerash kapacitet – çmim (MW - €/MWh). Çmimi i ofertës nuk përfshin tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), që llogaritet veçmas nga OST-ja.

Vlera minimale e kapacitetit që kërkohet në një ofertë është 1 MW dhe vlera maksimale e ofertës dhe/ose ofertave është i/e barabartë me vlerën e ATC. Çmimi i ofertës jepet në €/MWh, me dy shifra dhjetore, dhe vlera minimale që mund të ofrohet është 0.01 €/MWh.

Pas mbarimit të afatit për paraqitjen e ofertave, OST-ja grupon ofertat për çdo kufi, drejtim, periudhë kohore, dhe i rendit sipas çmimit të ofruar në rend zbritës, duke formuar një listë ofertash “kapacitet – çmim” në rend zbritës.

Oferta e fundit e pranuar mund të reduktohet në rast se kapaciteti i mbetur është më i vogël se kapaciteti i kërkuar. Çmimi i ofertës është i vlefshëm edhe për këtë kapacitet të reduktuar. Në rast se për kapacitetin e mbetur, ka dy ose më shumë oferta me çmim të njëjtë, atëherë reduktimi i kapacitetit bëhet në mënyrë proporcionale me kapacitetin e kërkuar për çdo ofertë, duke bërë rrumbullakimin në vlerën e plotë më të vogël.

Me paraqitjen e kërkesës, pjesëmarrësi pranon se oferta e tij mund të reduktohet sipas procedurës së ankandit eksplicit (në rast se oferta e tij është e fundit në listë dhe nuk mund të realizohet plotësisht), dhe çmimi i ofruar është i vlefshëm për çdo reduktim të kapacitetit.

Në rast se shumica e kapaciteteve të ofertave, për një kufi, drejtim dhe intervalin kohor respektiv, është më e madhe se kapaciteti disponibël (ATC) i publikuar sipas procedurës së ankandit, atëherë pjesëmarrësit që kanë fituar të drejtën e transmetimit në ankand, janë të detyruar të paguajnë rezervimin e kapacitetit ndërkuftar, të llogaritur sipas formulës:

Pagesa (€) = [çmimi marxhinal (€/MWh) x kapaciteti i alokuar (MW) x numri i orëve të periudhës së ankandit (orëve të muajit ose një pjesë të tij)]

5.4. Njoftimi i rezultateve të ankandit

Me mbarimin e procedurës së ankandit vjetor dhe mujor, OST-ja njofton çdo pjesëmarrës të ankandit dhe publikon brenda dy ditëve kalendarike nga dita e zhvillimit të ankandit në faqen e vet të internetit, lidhur me rezultatet duke i dërguar një informacion në formë elektronike për:

- përcaktimin e kufirit, drejtimit dhe periudhës relevante;

- kapacitetin transmetues disponibël ATC (MW);
- vlerën e kërkuar të kapacitetit në ofertë (MW) dhe çmimin e ofertës (€/MWh);
- statusin e ofertës (e pranuar, e pranuar pjesërisht, e refuzuar);
- vlerën e alokuar të kapacitetit (MW) dhe çmimin (€/MWh);
- vlerën totale të kapacitetit të kërkuar;
- vlerën totale të kapacitetit të alokuar;
- numrin e pjesëmarrësve që morën pjesë në ankand;
- numrin e pjesëmarrësve që përfitojnë të drejtën e transmetimit;
- numrin total të ofertave për atë kufi dhe drejtim.

Pjesëmarrësit në ankand mund të kërkojnë sqarime në OST-në lidhur me rezultatet e ankandit, jo më vonë se ora 12:00 e ditës së dytë pas marrjes së njoftimit përkatës nga OST-ja. OST-ja jep përgjigje në lidhje me këto kërkesa për sqarim brenda orës 14:00 të së njëjtës ditë. Nëse pjesëmarrësi në ankand nuk paraqet ndonjë ankim brenda kohës së caktuar, atëherë rezultati i njoftuar konsiderohet përfundimtar dhe shërben si bazë për llogaritjen e pagesës së rezervimit dhe faturimit.

Pas mbylljes së çdo ankandi, brenda dy ditëve, OST-ja publikon në faqen e vet të internetit, një tabelë me të dhënat e përgjithshme të rezultateve, ku përfshihet:

- kufiri dhe drejtimi;
- periudha e ankandit;
- kapaciteti disponibël ATC;
- kapaciteti total i kërkuar në oferta;
- kapaciteti total i alokuar në ankand;
- të gjitha ofertat e paraqitura, duke përcaktuar për çdo pjesëmarrës kapacitetin e ofruar, si dhe çmimin/njësi për çdo kufi dhe drejtim;
- emrat e të gjitha shoqërive pjesëmarrëse në ankand, duke përcaktuar për çdo pjesëmarrës kapacitetin që ka fituar apo jo për çdo kufi dhe drejtim, si dhe çmimin marxhinal (çmimi më i ulët i ofertës së fundit të pranuar nga OST-ja në një procedurë ankandi) që do të paguhet nga të gjitha shoqëritë fituese;
- kodin e kontratës me OST-në për alokimin e kapacitetit;
- informacion mbi prezencën/mungesën e kongestionit.

Brenda 5 ditëve pune nga dita e zhvillimit të ankandit, OST-ja publikon në faqen e vet të internetit, për çdo kufi dhe drejtim, një paraqitje grafike me vlerat e çifteve çmim – kapacitet.

Për ankandet ditore, rezultatet e ankandit publikohen në ditën pasardhëse të ankandit (D-1) ndërmjet orës 8:05 deri në 8:30. Pjesëmarrësit mund të kërkojnë sqarime lidhur me ankandin ditor brenda orës 9:00 të ditës D-1 dhe OST-ja do të japë sqarimet përkatëse brenda orës 10:00 të së njëjtës ditë.

5.5. Llogaritja e pagesës për rezervimin e kapacitetit ndërkufitar dhe taksa e vlerës së shtuar

A) Ankandi vjetor/mujor

Pagesa për rezervimin e kapacitetit ndërkufitar që i alokohet pjesëmarrësve në ankandet vjetore/mujore, llogaritet në bazë mujore sipas numrit të planifikuar të orëve të përdorimit të mundshëm të kapacitetit të alokuar. Pagesa do të bëhet në avancë, para fillimit të përdorimit të së drejtës së transmetimit, sipas faturës (pro-forma) që emetohet nga OST-ja jo më vonë se 8 ditë para fillimit të muajit në të cilin do të përdoret e drejta e transmetimit, dhe data e faturimit publikohet në kalendarin e procedurës së ankandit. OST-ja i dërgon një faturë me bazë mujore çdo pjesëmarrësi në ankandin vjetor/mujor. Në këtë faturë llogaritet dhe shënohet veçantë edhe taksa e vlerës së shtuar (TVSH) prej 20% të shumës së kalkuluar sipas formulës së mësipërme për përdorimin e kapacitetit. Secila nga shumat e mësipërme, si dhe totali i tyre, paraqiten në faturë në euro (€). Pjesëmarrësit do të paguajnë shumën totale të shënuar në faturë, e cila përfshin edhe TVSH-në. Pagesa e faturës do të bëhet në llogarinë e OST-së në lekë ekuivalente me shumën në euro, e llogaritur me kursin mesatar ditor të shkëmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e pagesës. Instruksione mbi pagesën do të jepen edhe në faturën e emetuar nga OST-ja. Afati i fundit i pagesës së faturës është 3 ditë punë pas marrjes së faturës të lëshuar nga OST-ja nga pjesëmarrësi në ankand. Fatura duhet të paguhet e plotë, pa asnjë reduktim apo kompensim, në llogarinë e OST-së, brenda afatit të përcaktuar në faturë. Në rast se pjesëmarrësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai humbet të drejtën e përdorimit të kapacitetit transmetues të alokuar për muajin përkatës, dhe nuk do të lejohet të marrë pjesë në ankandin e muajit pasardhës, deri

sa të paguajë shumën e plotë të faturës dhe interesin përkatës të llogaritur sipas kohëvonesës.

B) Të dhënat e faturës

Fatura do të dërgohet me faks dhe postë, dhe do të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- përcaktimin teknik të kufijve/drejttimeve për të cilat kapaciteti i është alokuar pjesëmarrësit;
- numri i ofertës në ankand;
- kapaciteti i alokuar (MW);
- çmimi i ofertës (€/MWh);
- numri i planifikuar i orëve të përdorimit të kapacitetit (orë);
- vlera e pagesës për rezervimin e kapacitetit ndërkufitar (euro);
- vlera e TVSH (euro);
- vlera totale e faturës që duhet të paguhet nga pjesëmarrësi (euro).

6. Transferimi i kapacitetit të alokuar

Pjesëmarrësi që ka fituar të drejtën e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar, nuk mund ta kthejë këtë kapacitet në OST, qoftë edhe pjesërisht, në shkëmbim të kthimit të pagesës përkatëse që ka bërë pavarësisht nga arsyeja e pamundësisë së përdorimit të këtij kapaciteti në përputhje me parimin “Përdore ose humbe” (UIOLI).

Pjesëmarrësi mund ta transferojë kapacitetin e fituar në ankand te një ose disa pjesëmarrës të tjerë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Transferimi te një ose me shumë pjesëmarrës të tjerë të tregut, mund të bëhet vetëm me lejen dhe pëlqimin e OST-së. Palët që kanë rakorduar transferimin e kapacitetit, janë të detyruar të dërgojnë në OST një kërkesë të përbashkët për realizimin e transferimit të kapacitetit. Kërkesa bëhet me shkrim sipas formularit “Kërkesë për transferim kapaciteti” që i bashkëngjitet këtyre rregullave. Kërkesa duhet të plotësohet me korrektësi, si me të dhënat e palës që transferon kapacitetin, ashtu edhe me ato të palës që merr kapacitetin, dhe e nënshkruar nga personat e autorizuar të palëve, dërgohet me faks ose dorazi në OST.

Kërkesa për transferim kapaciteti është e detyrueshme për të dyja palët, dhe pas dërgimit të saj në OST, ajo nuk mund të ndryshohet apo të tërhiqet. Brenda një dite punë, pas marrjes së kërkesës për transferim kapaciteti, OST-ja do t'i përgjigjet me shkrim të dyja palëve të interesuara për transferimin e kapacitetit. Në rast se palët kanë respektuar të gjitha dispozitat dhe kërkesat e këtyre rregullave, OST-ja është e detyruar që të pranojë kërkesën për transferim. Në rast të kundërt, kërkesa do të refuzohet.

Pjesëmarrësit e tregut mund të transferojnë kapacitetin në sasinë e plotë ose të pjesshme. Kapaciteti minimal që mund të transferohet është 1 MW. Kapaciteti mund të transferohet për të gjithë periudhën e ankandit (muajore) ose për një pjesë të saj. Periudha minimale është një ditë (24 orë).

Transferimi i kapacitetit mund të realizohet vetëm nga pjesëmarrësi që ka kryer pagesën për rezervimin e kapacitetit sipas faturës së dërguar nga OST-ja për muajin përkatës kur bëhet transferimi, gjithashtu, pjesëmarrësi që përfiton kapacitetin duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet kundrejt OST-së, e cila për realizimin e transferimit të kapacitetit ndërmjet palëve, nuk i ngarkon ato me ndonjë detyrim financiar.

Kërkesa për transferim të kapacitetit vjetor/mujor depozitohet pranë OST-së 3 (tri) ditë kalendarike përpara periudhës, mujore ose ditore, së fillimit të livrimit.

OST sh.a. publikon në faqen e internetit të saj të dhënat e mëposhtme në lidhje me transferimin e kapaciteteve:

- Emrin e shoqërisë që transferon kapacitetin;
- Emrin e shoqërisë përfituese;
- Kapacitetin e energjisë (MW) që transferohet për çdo orë;
- Kufirin dhe drejtimin e kapacitetit që transferohet.

7. Zbatimi i të drejtës së përdorimit të kapacitetit ndërkufitar të alokuar

E drejta e përdorimit të kapacitetit të alokuar, zbatohet nëpërmjet nominimit të skedulimeve të shkëmbimit ndërkufitar, në përputhje me Kodin e Rrjetit dhe rregullat e tregut në fuqi.

Pjesëmarrësi i tregut që fiton të drejtën e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar nga ankandi i organizuar nga OST-ja ose nga ankandet që bëhen nga TSO-të fqinjë, e aplikon këtë të drejtë nëpërmjet nominimit të skedulimeve të shkëmbimit ndërkufitar. Në rast se e drejta e transmetimit jepet nga operatorët fqinjë, pjesëmarrësi i tregut që e përfiton këtë të drejtë është i detyruar të njoftojë OST-në nëpërmjet plotësimi të formularit përkatës që është pjesë integrale e këtyre rregullave, dhe që dërgohet me faks ose dorazi në OST, jo më vonë se tre ditë para fillimit të muajit përkatës ose para ditës kur e

drejta e transmetimit” bëhet efektive.

Vlerat e nominuara në skedulimin ndërkuftar nuk mund të tejkalojnë kapacitetin total të transmetimit të alokuar për çdo pjesëmarrës.

E drejta e përdorimit të kapacitetit ndërkuftar ekzekutohet në bazë të principit “përdore ose humbe” dhe në përputhje me Kodin e Transmetimit.

Të gjithë zotëruesit e kapaciteteve vjetore dhe mujore duhet që të deklarojnë përdorimin e kapaciteteve jo më vonë se dita D-2, ora 10:00 për ditën D. Ndryshimet e nominimeve pas kësaj kohe nuk janë të mundshme.

Kapacitetet që nuk nominohen brenda afatit të fundit të nominimit, nuk mund të përdoren ose transferohen nga zotëruesit e tyre dhe konsiderohen të humbura. Zotëruesit e kapaciteteve nuk do të kompensohen, rimbursohen apo zhdëmtohen për kapacitetet e panominuara, edhe në rast se OST-ja do të zhvillojë ankande ditore për të rialokuar kapacitetet e panominuara.

Në rast se zotëruesi i kapacitetit nuk e përdor kapacitetin e deklaruar tek OST-ja, atëherë ai nuk do të lejohet të marrë pjesë në ankandin e muajit pasardhës.

Në rast se zotëruesi i kapacitetit në mënyrë sistematike nuk e përdor kapacitetin e deklaruar tek OST-ja, atëherë ai nuk do të lejohet të marrë pjesë në ankandet e gjashtë muajve pasardhës.

Shoqëritë që kanë të drejta të siguruara sipas pikës 1 të këtyre rregullave, deklarojnë përdorimin e kapaciteteve të rezervuara dy ditë pune përpara ditës së zhvillimit të ankandit mujor, dhe në rast të mos deklarimit, aplikohen të gjitha dispozitat e mësipërme.

8. Kufizimi i të drejtës së përdorimit të kapacitetit të alokuar në ankand

OST-ja është e detyruar të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar realizimin e të drejtës së përdorimit të kapacitetit ndërkuftar të alokuar në ankande. OST-ja mund të reduktojë vlerat e paracaktuara të kapacitetit ndërkuftar, të alokuar në ankandet vjetore/mujore, për shkaqe teknike në kohën para përdorimit ose gjatë periudhës së përdorimit të kapacitetit. Kapaciteti i alokuar sipas rezultateve të ankandeve, nuk është i garantuar në rastet e përshkruara në rregullat e tregut dhe në këto rregulla.

E drejta e përdorimit të kapacitetit ndërkuftar për çdo pjesëmarrës dhe në çdo kufi/drejtim të alokuar në ankandet vjetore, mund të reduktohet pjesërisht ose plotësisht, për një periudhë të caktuar kohe, për shkaqe teknike të planifikuara dhe të njohura në avancë (të skeduluara), si dhe për shkaqe që nuk mund të planifikohen ose parashikohen në avancë (të paskeduluara).

Në rastet e reduktimit të përdorimit të kapacitetit për shkaqe të skeduluara, pjesëmarrësit (zotëruesit e kapacitetit) do të njoftohen për këtë, jo më vonë se 10 ditë para fillimit të muajit përkatës kur është planifikuar të bëhet reduktimi i kapacitetit ndërkuftar. Reduktimi do të bëhet në mënyrë proporcionale sipas kapacitetit që ka fituar secili pjesëmarrës në kufirin/drejtimin përkatës.

Reduktimi i kapacitetit ndërkuftar të alokuar në ankandet vjetore/mujore, për shkaqe të paskeduluara përfshin reduktimin e kapacitetit neto (NTC) për shkaqe të papritura, në kushtet e emergjencës në sistemin elektro-energjetik të vendit dhe/ose në sistemet e vendeve fqinje, sipas përcaktimit të bërë në Kodin e Transmetimit, në rastet e veprimit të forcave madhore, si dhe në rastet e pezullimit të tregut të energjisë elektrike të parashikuar në kapitullin XIII të rregullave të tregut.

Në rastet e reduktimit të kapacitetit ndërkuftar të alokuar në ankandet vjetore/mujore, për rastet e kufizimeve për shkaqet e parashikuara si forcë madhore sipas pikës 40, të nenit 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pjesëmarrësit (zotëruesit e kapacitetit) nuk kanë të drejtë të kërkojnë rikthimin ose kompensimin e shumës së paguar për rezervimin e të drejtës së përdorimit të kapacitetit ndërkuftar.

OST-ja mund të pezullojë të drejtën e përdorimit të kapacitetit ndërkuftar në muajin përkatës për çdo pjesëmarrës, nëse zotëruesi i kapacitetit dështon në plotësimin e rregullave të OST-së dhe ENTSO-E lidhur me nominimin dhe harmonizimin e skedulimeve të shkëmbimit, si dhe nëse zotëruesi i kapacitetit ka detyrime financiare të pashlyera kundrejt OST-së. Në këtë rast zotëruesi i kapacitetit humbet të drejtën e pjesëmarrjes në ankandin e muajit të ardhshëm, deri sa të plotësojë të gjitha detyrimet kundrejt OST-së.

9. Publikimi i informacionit në faqen e internetit të OST sh.a.

Informacioni minimal i detyruar për t’u publikuar në faqen e internetit të OST-së përmban:

- a) Rregullat e ankandit dhe të gjitha ndryshimet e tyre;
- b) Njoftimet sipas rregullave të ankandit;
- c) Specifikimet e ankandit;

- d) Emri, faksi dhe numri/numrat i/e telefonit/telefonave, adresa/adresat e postës elektronike (e-mail) dhe personi i kontaktit nga OST-ja;
- e) Formularët dhe dokumentet që do të shkarkohen dhe përdoren nga përdoruesit në lidhje me ankandin;
- f) kapaciteti neto i transmetimit (NTC);
- g) kapacitetin e transmetimit disponibël (ATC);
- h) kapacitetin transmetues të alokuar (AAC);
- i) tabelën e rezultateve të ankandit;
- j) kufizimet e planifikuara;
- k) periudhat e remontit;
- l) kalendari tregues për ankandet vjetore dhe mujore;
- m) lista e pjesëmarrësve në ankand;
- n) informacione të tjera përkatëse.

10. Monitorimi i alokimit të kapaciteteve

Të gjitha operacionet e alokimit do të dokumentohen me saktësi. Asnjë alokim nuk lejohet të kryhet pa dokumentacionin shoqëruar të kërkuar.

Deri në datën 10 të çdo muaj OST sh.a. paraqet në ERE një raport analitik informues dhe argumentues mbi alokimin e kapaciteteve në zbatim të këtyre rregullave.

OST sh.a. ka detyrimin t'i japë në mënyrë transparente ERE-s të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj, për alokimet e kapaciteteve të interkonjeksioneve në kuadër të autoritetit të ERE-s për të monitoruar të licencuarit.

11. Rishikimi

Këto rregulla janë objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

12. Hyrja në fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi në datë 1.7.2011.

Shtojca 2: Modeli i kontratës

1. Operatori i sistemit të transmetimit shqiptar (OST sh.a.), Tiranë, bulevardi “Gjergj Fishta” nr.10, me numër regjistrimi _____, me numër taksë identifikimi _____, i përfaqësuar nga drejtori i kompanisë _____,

dhe

2. xxx _____ (adresa, nr. regjistrimi, nr. identifikimi takse), i përfaqësuar nga _____,

Këtu të quajtura palë, konkludojnë:

KONTRATË

Mbi të drejtën e përdorimit të kapacitetit transmetues ndërkufitar në kufijtë e zonës së kontrollit të OST-së, për vitin 2011

I. Subjekti i kontratës

Neni 1

1.1 Kjo kontratë specifikon të drejtat dhe obligimet e ndërmjet OST-së dhe xxx si pjesëmarrës në tregun e energjisë në Shqipëri, lidhur me alokimin e kapacitetit transmetues disponibël (ATC) në ankandet vjetore, mujore dhe ditore, dhe ushtrimin e të drejtës për të përdorur kapacitetin e alokuar dhe nominimin e skedulimeve.

1.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, xxx deklaron se ka njohje të plotë, dhe në mënyrë të pakthyeshme pranon pa rezerva ose limitime “Rregullat për alokimin e kapacitetit ndërkufitar në kufijtë e zonës së kontrollit të menaxhuar nga OST-ja (këtu më poshtë referuar si “Rregullat”); që janë përcaktuar nga OST-ja dhe publikuar në faqen e saj të internetit.

II. Përdorimi i kapacitetit ndërkufitar të alokuar dhe balancimi i skedulimit.

Neni 2

2.1 XXX shfrytëzon të drejtën e tij për përdorimin e kapacitetit transmetues ndërkufitar duke marrë pjesë në ankandet e kapaciteteve të organizuara nga OST-ja në akordancë me rregullat e alokimit të kapacitetit ndërkufitar.

2.2 XXX shfrytëzon përdorimin e kapacitetit të alokuar me anë të nominimit të shkëmbimeve ndërkufitare, që ia dërgon OST-së në akordancë me rregullat e tregut, Kodin e Rrjetit, rregullat e ENTSO-E, rregullat dhe dokumentet mbi mundësinë e reduktimit të import/eksportit të energjisë elektrike konform rregullave të tregut.

2.3 E drejta e përdorimit të kapacitetit transmetues ndërkufitar që i është alokuar XXX në ankandet vjetore, mujore, nuk është e garantuar nga OST-ja, pasi vlera e përcaktuar paraprakisht e kapacitetit ndërkufitar në nivel vjetor, mujor, ditor mund të zvogëlohet para momentit të përdorimit të kapacitetit të alokuar. Ky reduktim do të bëhet në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara në rregullat e tregut.

2.4 XXX nuk i jepet e drejta e rimbursimit të dëmit ose humbjes së fitimit, për shkak të reduktimit të së drejtës të përdorimit të kapacitetit ndërkufitar, për shkak për të cilat OST-ja nuk është përgjegjëse.

III. Faturimi dhe pagesa e tarifave.

Neni 3

3.1 Tarifa e së drejtës e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar, për kapacitetin e alokuar në ankande (vjetor dhe mujor), do të kalkulohet në bazë mujore sipas numrit të planifikuar të orëve të përdorimit të mundshëm të kapacitetit ndërkufitar. XXX është i detyruar të paguajë në OST shumën e plotë të tarifës për rezervimin e kapacitetit ndërkufitar që i është alokuar në ankand. XXX do të paguajë tarifën përpara fillimit të përdorimit të së drejtës së transmetimit, sipas faturës së emetuar nga OST-ja.

3.2 Në faturë, vlera e TVSH-së prej 20% i shtohet shumës së tarifës së kapacitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Secila prej shumave të lartpërmendura, si dhe totali do të paraqiten në faturë në euro (EUR). XXX është i detyruar të paguajë shumën totale të shënuar në faturë. Pagesa e faturës do të bëhet në llogarinë e OST-së në lekë në vlerë të barabartë me shumën në euro të faturës, sipas kursit të Bankës Shqiptare në ditën e pagesës. Instruksione mbi pagesën jepen në faturë.

Kushtet e përgjithshme të faturimit

3.3 Për përdorimin e kapacitetit të alokuar në ankande, XXX duhet të bëjë pagesën e shënuar në faturë, në avancë, për çdo muaj, në llogarinë e OST-së në bankën që deklarohet në faturë.

3.4 OST-ja do të emetojë faturën përkatëse për XXX për kapacitetin e alokuar në ankand, jo më vonë se 8 (tetë) ditë para fillimit të muajit që vjen, për të cilin, është dhënë e drejta e përdorimit të kapacitetit. Fatura i transmetohet XXX me faks dhe origjinali i dërgohet me postë.

3.5 Fatura e dërguar nga OST-ja duhet të paguhet brenda 3 (tri) ditëve pune nga dita e emetimit. Pagesa konsiderohet efektive kur shumat respektive e parave është derdhur në llogarinë e OST-së.

3.6 XXX është i detyruar të paguajë shumën e plotë të faturuar, pa ndonjë reduktim apo kompensim, në llogarinë e OST-së, brenda kohës së përcaktuar në faturë.

3.7 Në rast vonese për pagesën, OST-ja do të ngarkojë XXX me interesin në normën e interesit bankar.

3.8. Me normë të interesit bankar do të kuptohet norma e interesit të depozitave njëditore të aplikuara nga Banka e Shqipërisë në marrëdhëniet e saj me bankat e nivelit të dytë, të publikuara nga Banka e Shqipërisë, në ditën më të afërt nga dita e parë e llogaritjes së interesave të vonesës.

3.9 XXX do të paguajë shumën e plotë të faturës deri në afatin e përcaktuar, pavarësisht nga ndonjë obligim i mundshëm i pashlyer nga ana e OST-së në drejtim të XXX për çfarëdolloj arsyeje.

3.10 Nëse XXX dështon në shlyerjen e detyrimeve financiare kundrejt OST-së brenda kohës së përcaktuar, OST-ja ka të drejtë të marrë masa kundrejt XXX, duke ndërprerë nominimin e skedulimeve, të drejtën e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar dhe të drejtën e pjesëmarrjes në ankandet e kapaciteteve, deri sa të bëhet pagesa përkatëse në përputhje me rregullat.

IV. Amendamentet e të drejtave dhe detyrimeve

Neni 4

4.1 XXX mund të bëjë transferimin e kapacitetit ndërkufitar në mënyrën dhe sipas kushteve të përshkuara në rregullat.

4.2 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj kontrate bëhet e pavlefshme si pasojë e amendimeve të mundshme të rregullave, dispozitat e tjera të kontratës që përjashtohen nga amendimi do të mbeten në fuqi dhe do të interpretohen në përputhje me amendimin e specifikuar të rregullave.

4.3 Asnjë amendament i kësaj kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk bëhet me shkrim dhe me pëlqimin e të dyja palëve.

V. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 5

5.1 Palët do të mundohen të zgjidhin mosmarrëveshjet e mundshme gjatë zbatimit të kësaj kontrate, në mënyrë miqësore.

5.2 Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, ajo do të zgjidhet nëpërmjet gjykatës kompetente.

5.3 Gjatë kohës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes, palët nuk do të ndërpresin performancën e kontratës, vetëm nëse rrethanat e rastit kërkojnë ndërprerjen ose pezullimin e disa të drejtave të përdorimit të kapacitetit të alokuar.

VI. Konfidencialiteti

Neni 6

6.1 Palët bien dakord që obligimet e përcaktuara në këtë kontratë dhe informacioni i prezantuar në të, do të konsiderohen konfidenciale, dhe se ata nuk do t'i zbulojnë ato në palët e treta dhe nuk do t'i publikojnë ato gjatë kohës kur kontrata është efektive, përveç të dhënave që OST-ja publikon në faqen e saj të internetit, bazuar në detyrimet e saj që burojnë nga rregullat e ankandeve.

6.2 Nëse është e nevojshme të jepet ky lloj informacioni, autoriteteve shtetërore, organizatave dhe institucioneve, ku Republika e Shqipërisë ose OST-ja është anëtare, atëherë çdo palë do të informojë për këtë palën tjetër me shkrim, para se të japë informacionin e kërkuar.

VII. Hyrja në fuqi e kontratës

Neni 7

7.1 Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve.

7.2 Kjo kontratë është bërë në pesë kopje identike, dy për XXX dhe tri për OST-në.

Nënshkrimi i përfaqësuesve të autorizuar

Për OST

Për XXX

Formulari i Kerkeses per Transferimin e Kapacitetit

Data e paraqitjes se kerkeses: _____

1. Kerkese e detyrueshme per transferimin e kapacitetit nga te dy pjesmarresit e tregut sebashku

Kufiri/Drejtimi	Ankandi	Periudha e perdorimit te te drejtave te kapacitetit	Kapaciteti
		dd.mm.vvvv. – dd.mm.vvvv.	MW
Mali i Zi - Shqiperi			
Kosove - Shqiperi			
Greqi - Shqiperi			
Shqiperi – Mali i Zi			
Shqiperi - Kosove			
Shqiperi - Greqi			

2. Pranimi i transferimit te kapacitetit

	Transferuesi Dhenes	Transferuesi Marres
Emri i Kompanise		
Personi i autorizuar		
Nr.Tel.		
Nr.Fax.		
E-mail		
Firma dhe Vula		

3. Konfirmimi i OST sh.a.'

Personi i autorizuar	
Data e Konfirmimit	
KOMENTE	
Firma dhe Vula	

Formulari i Deklarimit te Marrjes se te Drejtes se Transmetimit Nderkufitar te Alokuar nga TSO-te fqinje

Treguesi Teknik i Kufijve/Drejtimimit:	_____ 1)																																																	
Periudha e nje ose me shume diteve per te drejatat e kapacitetit nderkufitar te alokuara me baze vjetore, mujore, ose javore me ankand nga OST-te fqinje	From: _____.20..... (dd1.mm1.20.....)	To: _____.20..... (dd2.mm2.20...)																																																

“Band” Sasia e Kapacitetit (MW)	_____																																																	
Vlerat ditore dhe orare ne rast te alokimit me ankand ditor te te drejtes se kapacitetit nderkufitar ose alokimit ne ankand vjetor, mujor ose javor te kapacitetit jo ne “band” (MW) (te alokuar nga OST-te fqinje)	_____.20..... (dd.mm.20.....)																																																	
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <tr> <td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td><td>8</td><td>9</td><td>10</td><td>11</td><td>12</td><td>13</td><td>14</td><td>15</td><td>16</td><td>17</td><td>18</td><td>19</td><td>20</td><td>21</td><td>22</td><td>23</td><td>24</td> </tr> <tr> <td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td><td> </td> </tr> </table>			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24																								
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24																											

TSO	_____ 2)	OST sh.a.
Emri i Kompanise		
Adresa e Kompanise		
Personi i autorizuar		
Nr.Tel.		
Nr.Fax.		
E-mail		
Data		
Firma e personit te autorizuar		
Vula e personit te autorizuar		

1)
Ketu vendosen shkurtime qe mund te perdoren per kufijte dhe drejtimet psh: ALRS – per kufijte dhe drejtimet nga Shqiperia drejt Serbise
RSAL –per kufijte dhe drejtimet nga Serbia drejt Shqiperise etj....

2)
Ketu shkruhen sqarime ne lidhje me shkurtime qe mund te perdoren per emertimin e OST-ve fqinje psh.: EMS – OST Serbi, etj.....

3)
Ne rast te nje dite – dd2.mm2.20...mbeten bosh

LISTA E PERSONAVE TË KONTAKTIT NË OST

.....Mbiemer.....Funksioni dhe I Ngarkuar meNr. tel.....Nr. Fax....E-mail.....

.....Mbiemer.....Funksioni dhe I Ngarkuar meNr. tel.....Nr. Fax....E-mail.....

.....Mbiemer.....Funksioni dhe I Ngarkuar meNr. tel.....Nr. Fax....E-mail.....

.....Mbiemer.....Funksioni dhe I Ngarkuar meNr. tel.....Nr. Fax....E-mail.....

.....Mbiemer.....Funksioni dhe I Ngarkuar meNr. tel.....Nr. Fax....E-mail.....

.....Mbiemer.....Funksioni dhe I Ngarkuar meNr. tel.....Nr. Fax....E-mail.....

.....Mbiemer.....Funksioni dhe I Ngarkuar meNr. tel.....Nr. Fax....E-mail.....

.....Mbiemer.....Funksioni dhe I Ngarkuar meNr. tel.....Nr. Fax....E-mail.....

LISTA E PJESËMARRËSVE TË TREGUT QË MUND TË MARRIN PJESË NË ANKAND DHE NË NOMINIMIN E SKEDULIMEVE

EMRI I PLOTE	
ADRESA (SELIA)	
NIPTI	
LLOJI, NUMRI DHE DATA E LIÇENCES	
ADRESA(Nr. Tel, Nr. Fax. E-mail) DHE PERSONI I AUTORIZUAR I KONTAKTIT (Emri dhe Mbiemri)	
DATA E LIDHJES SE KONTRATES PER TE DREJTEN E PERDORIMIT TE KAPACITETIT NDERKUFITAR NE KUFIJTE E ZONES SE KONTROLLIT	
EMRI I PLOTE	
ADRESA (SELIA)	
NIPTI	
LLOJI, NUMRI DHE DATA E LIÇENCES	
ADRESA(Nr. Tel, Nr. Fax. E-mail) DHE PERSONI I AUTORIZUAR I KONTAKTIT (Emri dhe Mbiemri)	
DATA E LIDHJES SE KONTRATES PER TE DREJTEN E PERDORIMIT TE KAPACITETIT NDERKUFITAR NE KUFIJTE E ZONES SE KONTROLLIT	
EMRI I PLOTE	
ADRESA (SELIA)	
NIPTI	
LLOJI, NUMRI DHE DATA E LIÇENCES	
ADRESA(Nr. Tel, Nr. Fax. E-mail) DHE PERSONI I AUTORIZUAR I KONTAKTIT (Emri dhe Mbiemri)	
DATA E LIDHJES SE KONTRATES PER TE DREJTEN E PERDORIMIT TE KAPACITETIT NDERKUFITAR NE KUFIJTE E ZONES SE KONTROLLIT	
EMRI I PLOTE	
ADRESA (SELIA)	
NIPTI	
LLOJI, NUMRI DHE DATA E LIÇENCES	
ADRESA(Nr. Tel, Nr. Fax. E-mail) DHE PERSONI I AUTORIZUAR I KONTAKTIT (Emri dhe Mbiemri)	
DATA E LIDHJES SE KONTRATES PER TE DREJTEN E PERDORIMIT TE KAPACITETIT NDERKUFITAR NE KUFIJTE E ZONES SE KONTROLLIT	

TABELA ME VLERAT E TTC, TRM, NTC, AAC DHE ATC NË MW

Interkonjeksioni me Malin e Zi

Kufiri/drejtimi	Periudha	TTC	TRM	NTC	AAC	ATC
Shqipëri-Mali i Zi	1-30/.../2010		50		0	
Mali i Zi-Shqipëri	1-30/.../2010		50		0	

Interkonjeksioni me Kosovën

Kufiri/drejtimi	Periudha	TTC	TRM	NTC	AAC	ATC
Shqipëri-Kosovo	1-30/.../2010		50		0	
Kosovë-Shqipëri	1-30/.../2010		50		0	

Interkonjeksioni me Greqinë

Kufiri/drejtimi	Periudha	TTC	TRM	NTC	AAC	ATC
Shqipëri-Greqi	1-30/.../2010		100		0	
Greqi-Shqipëri	1-30/.../2010		100		0	

Plani vjetor paraprak i remonteve të interkonjektorëve

Interkonjeksi	Periudha	
	Nga data	Deri në datën
Shqipëri-Mal i Zi Linja 400 kV		
Shqipëri-Mal i Zi Linja 220 kV		
Shqipëri-Kosovë		
Shqipëri-Greqi		

Tabela me rezultatet e ankandit

NUMRI DHE DREJTIMI	
PERIUDHA E ANKANDIT	
KAPACITETI DISPONIBËL ATC	
KAPACITETI TOTAL I KËRKUAR NË OFERTA	
KAPACITETI TOTAL I ALOKUAR NË ANKAND	
KARTA E FUNDIT E PRANUAR, NË RAST TË KONGJESTIONIT	
NUMRI I PJESËMARRËSVE QË MORËN PJESË NË ANKAND	
NUMRI I PJESËMARRËSVE QË PËRFITOJNË TË DREJTËN E TRANSMETIMIT	
NUMRI TOTAL I OFERTAVE	
PËRDORIMI I OFERTËS SË FUNDIT TË PRANUAR	
INFORMACION MBI PREZENCËN/MUNGESËN E KONGJESTIONIT	

FORMULARI I APLIKIMIT PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN E KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR PERIUdhËN

e paraqitjes: _____

EMRI I PLOTE	
ADRESA (SELIA)	
NIPTI	
LLOJI, NUMRI DHE DATA E LIÇENCES	
ADRESA KU DO TE DERGOHEN MARREVESHJET, ANEKSET E MARREVESHJEVE, /FATURAT	
E-MAIL KU DO TE DERGOHEN MARREVESHJET, ANEKSET E MARREVESHJEVE, FATURAT	
DREJTORI (OSE PERSONI I AUTORIZUAR) EMRI DHE MBIEMRI	
NR. TEL.	
NR. FAX	
E-MAIL	
PERSONI (OSE PERSONAT)PERGJEGJES PER ÇESHTJET FINANCIARE	
NR. TEL.	
NR. FAX	
E-MAIL	
PERSONI (OSE PERSONAT)PERGJEGJES PER TE MARRE PJESE NE PROCEDUREN E ALOKIMIT	
NR. TEL.	
NR. FAX	
E-MAIL	
PERSONI (OSE PERSONAT)PERGJEGJES PER PARAQITJEN E SKEDULEVE KY PERSON DUHET TE JETE I DISPONUESHEM <u>24 ORE NE DITE, 365 DITE TE VITIT</u>	
NR. TEL.	
NR. FAX	
E-MAIL	
ADRESA ZYRTARE E E-MAIL PER PARAQITJEN E SKEDULEVE DHE MESAZHEVE NE KETE KONTEKS	
Web-site	

[Shkruani: Emrin e kompanisë]

[Shkruani: Emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar]

[Shkruani: Titullin e personit të autorizuar]

[Lini hapësirë për: Firmën e personit të autorizuar]

Lini hapësirë për: Vulën e kompanisë]

VENDIM
Nr.19, datë 4.3.2011

PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT TË ERE-S NR.10,
DATË 18.2.2011

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2011, pasi shqyrtoi kërkesën ankimore të paraqitur nga shoqëria “Albanian Chrome” sh.p.k., për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e klientit tarifor,

konstatoi se:

Së pari, pretendimi i parë i shoqërisë “Albanian Chrome” sh.p.k., nuk qëndron, pasi ERE nuk ka miratuar aspak me një procedurë të shpejtuar kërkesën e shoqërisë “Antea Cement” sh.a. për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe marrjen e statusit të klientit tarifor, por ka marrë vendimin e saj brenda 30 ditëve, siç parashikohet në rregulloren për dhënien dhe heqjen e statusit të klientit të kualifikuar. Gjithashtu, vlen të përmendet fakti se ERE përpara se të merrte vendimin e saj për “Antea Cement” sh.a., ka marrë në konsideratë edhe konfirmimin nga ana e “CEZ Shpërndarje” sh.a., se është i gatshëm të furnizojë pa kosto shtesë shoqërinë “Antea Cement” sh.a. nga periudha e kërkuar nga vetë shoqëria “Antea Cement” sh.a. Ndërsa në rastin konkret “CEZ Shpërndarje” sh.a. edhe pse ERE ka pritur deri në ditën e fundit të afatit që përcakton rregullorja për dhënien dhe heqjen e statusit të klientit të kualifikuar, nuk ka depozituar asnjë konfirmim për të furnizuar shoqërinë “Albanian Chrome” sh.p.k. nga periudha e kërkuar nga kjo shoqëri.

Së dyti, sa i përket pretendimit të dytë të sipërpërmendur të “Albanian Chrome” sh.a., në interpretim të nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s “Ridëgjimi dhe ankimi kundër vendimit të Bordit”, vihemi përpara përgjegjësisë për të rishqyrtuar vendimin e ERE-s nr.10, datë 18.2.2011 “Për mosmiratimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Chrome” për marrjen e statusit të klientit tarifor sipas kërkesës së tij për kthimin në klient tarifor nga data 1 shkurt 2011, dhe sipas çmimeve të miratuara nga ERE me vendimin nr.100, datë 7.12.2010”. Kjo për arsye se shoqëria “Albanian Chrome” sh.p.k. në ankesën e paraqitur në ERE parashtron se ka siguruar një provë të re (konfirmimin e “CEZ shpërndarje” sh.a., për ta furnizuar pa kosto shtesë), e cila mund të ndryshojë vendimmarrjen e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të rishqyrtojë vendimin e saj nr.10, datë 18.2.2011 “Për mosmiratimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Chrome” për marrjen e statusit të klientit tarifor sipas kërkesës së tij për kthimin në klient tarifor, nga data 1 shkurt 2011, dhe sipas çmimeve të miratuara nga ERE me vendimin nr.100, datë 7.12.2010”, për të lejuar palën e interesuar të paraqesë provën e re.

2. Shoqëria “Albanian Chrome” sh.p.k. të paraqesë provën e re deri në datën 7 mars 2011.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “Albanian Chrome” sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.20, datë 4.3.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “RUDNAP ENERGY TIRANA” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “a”; 9, dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “f”, nenit 5 pika 1 germa “f”, nenit 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.21, datë 4.3.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KORKIS-2009” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Korkis-2009” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Korkis-2009” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Belesova 1” me fuqi 0.150 MW dhe “Belesova 2” me fuqi 0.280 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 7.4.2011
Doli nga shtypi më 9.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë